

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6073  
E hënë, 27 korrik 2020  
çmimi 0.40 €

Kosova regjistroi edhe  
8 viktima dhe 220 raste  
me koronavirus I FAQE 8



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", BILALL SHERIFI

## RAPORTUESJA VIOLA CRAMON THOTË TË PAVËRTETA PËR MANDATIN E GJYKATËS SPECIALE



Sekretari i Përgjithshëm i Nismës Socialdemokrate, Bilall Sherifi, e ka quajtur skandal vizitën e raportueses për Kosovën në Parlamentin Evropian, Viola von Cramon, në Gjykatën Speciale. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka vlerësuar se ajo ka thënë të pavërteta për mandatin e kësaj gjykate pas vizitës që i ka bërë në Hagë. Sherifi ka bërë me dije se ajo ka dezinformuar kur ka thënë: "Gjykata do të sjellë drejtësi në Kosovë ndaj atyre personave që besohet se kanë kryer krime lufte pavarësisht prej kombësisë së tyre". Sipas tij, nëse Von Cramon nuk e di që Gjykata Speciale do t'i dënojë vetëm shqiptarët, ajo duhet të kërkojë falje

## JO! MANDELA ISHTE DEMAÇI I AFRIKËS

(Muhamet Mavraj, 26. VII. '20. -  
Dy vjet pa Demaçin)



Më kanë pyetur për Demaçin  
Kam thënë Jo  
Ata dy janë vëllezër  
Por Mandela ishte Demaçi i Afrikës

Fundja, liria kudo është e njëjta racë  
Sikur duart që e kanë ves kultivimin e luleve  
E po kështu edhe ato që bëjnë barbari  
duke i prerë në emër të dashurisë

Dhe ende na quajnë "oborri i pasëm i  
shtëpisë"  
Faleminderit! Megjithatë, oborr

Ku lulet dhe liria nuk konsiderohen rryshfet

NË DYVJETORIN E VDEKJES PËRKUJTOHET SIMBOLI  
I REZISTENCËS KOMBËTARE, ADEM DEMAÇI

## ADEM DEMAÇI GJITHMONË DO TË MBETET NË KUJTESËN E KOMBIT SHQIPTAR



Simboli i rezistencës kombëtare për liri, pavarësi të Kosovës dhe bashkim kombëtar, Adem Demaçi, ishte njeriu që sakri-

fikoi gjithçka për të jetuar ne sot të lirë, të pavarur dhe sovranë. Kështu kanë thënë të dielën, në dyvjetorin e vdekjes

së Demaçit, përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës, të Shqipërisë dhe liderët e partive politike

## TRUMPI RIFITON ZGJEDHJET 2020

Shkruan: Seremb GJERGJI



**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçishtë-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË

**SPORT**  
GJILANI E ÇON  
FLAMURTARIN  
NË LIGËN E PARË  
F. 16

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegji.biznesi.com  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Samiti rajonal i liderëve të Ballkanit Perëndimor mbahet të mërkurën

PRISHTINË, 26 KORRIK - Përfaqësuesit e vendeve të Ballkanit Perëndimor do të marrin pjesë në samitin virtual të organizuar nga Këshilli Atlantik të mërkurën, më 29 korrik, njoftohet në faqen e kësaj organizate ndërkombëtare. Sipas njoftimit, pjesëmarrës në Samitin për partneritetin e Ballkanit Perëndimor do të jenë presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti dhe presidenti i Maqedonisë Veriore, Stevo Pendarovski. Shqipëria do të përfaqësohet nga kryeministri Edi Rama, Bosnje dhe Hercegovina nga kryetari i Këshillit të Ministrave Zoran Tegeltija, ndërsa Mali i Zi nga ministrja e Ekonomisë, Dragica Sekulic.

Temat e samitit, siç thuhet, do të jenë për përmirësimin e bashkëpunimit ekonomik rajonal. "Ndikime ekonomike dhe sociale të pandemisë Covid-19 në Ballkan kërkojnë veprime urgjente rajonale në mënyrë që ta shmangin ngecjen e përhershme ekonomike dhe paqëndrueshmërinë e mundshme që vjen me të. Masat e dakorduara në Samit, të lidhura dhe të integruara me nismat dhe dialogun ekzistues rajonal, do të dërgojnë një mesazh të rëndësishëm politik për të ardhmen euro-atlantike të Ballkanit Perëndimor në një kohë të pasigurisë së shtuar", Këshilli Atlantik. Këshilli Atlantik është një qendër e politikës së jashtme me bazë në Uashington.



## Vuçiqi: Nëse nuk i tërhiqet vërejtja Kosovës, do ta vazhdojmë fushatën për çnjohje



PRISHTINË, 26 KORRIK - Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, i është përgjigjur deklaratës së kryeministrit të Kosovës, Avdullah Hoti, se lobimi për njohjen e Kosovës nuk është pezulluar, duke thënë se ai do të presë për të parë se cila do të jetë organizata e parë ndërkombëtare ku do të aplikojë Kosova për anëtarësim dhe a do ta njohë dikush pavarësinë e Kosovës. "Në atë ditë, nëse mentorët e tyre nuk iu tërheqin vërejtjen, ne do ta vazhdojmë fushatën tonë (kundër njohjes së pavarësisë së Kosovës) dhe u premtoj atyre

që do të jemi pesë herë më të suksesshëm", tha Vuçiqi para gazetarëve gjatë një vizite në Sremska Mitrovicë. Vuçiqi tha se deklarata e Hotit tregoi se "nënshkrimi i shqiptarëve për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe (Zajednica) dhe fjala e dhënë (tek i dërguari amerikan për dialog Richard Grenellit, nuk do të thotë asgjë". Gjithashtu, Vuçiqi tha se delegacioni serb ishte i gatshëm për bisedime mbi ekonominë dhe se delegacioni i Kosovës erdhi në ato bisedime, siç tha ai, me kërkesë për

kompensim të luftës. "Kjo është ekonomi për ta, sepse ata nuk kanë fabrika dhe investime. Ne për këtë nuk do të flasim fare. Dialogu duhet të vazhdojë, por nëse thirrja është 'Ejani ta firmosni pavarësinë e Kosovës', as mos na thërrisni. Ne jemi gjithmonë për dialog dhe kompromise që çojnë në zgjidhje", ka thënë Vuçiqi. Kryeministri Hoti, gjatë një raportimi në Kuvendin e Kosovës të premtën mbi dialogun me Serbi, duke folur për lobimin për Kosovën tha, se "nuk ka pezullim të aktiviteteve tona".

## Certifikohen rezultatet e zgjedhjeve në Maqedoni, shqiptarët përfaqësohen në kuvend me 32 deputetë

SHKUP, 26 KORRIK - Komisioni shtetëror i zgjedhjeve në Maqedoninë e Veriut ka shpallur rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 15 korrikut. Në bazë të rezultateve që i kumtoi kryetari i KShZ-së, Oliver Derkovski, LSDM ka fituar 46 ulëse në Kuvend, VMRO DPMNE-44, BDI-15, Koalicioni Aleanca me Alternativën-12, E Majta-2 dhe PDSH-1 ulëse. Kuvendi i Maqedonisë së Veriut numëron 120 deputetë. Gjatë këtij mandati katërvjeçar shqiptarët do të përfaqësohen me gjithsej 32 deputetë shqiptarë nëpër parti dhe koalicione të ndryshme. Shpallja e rezultateve nga KShZ i hap rrugën konstituimit të përbërjes së re parlamentare, në

të cilën do të zgjidhet edhe kryetari i ri i Kuvendit. Në bazë të Kushtetutës, presidenti i shtetit, Stevo Pendarovski, mandatin për formimin e qeverisë së re do t'ia japë liderit të partisë apo subjektit politik që siguron shumicën parlamentare për formimin e qeverisë. Në garë për marrjen e mandatit janë LSDM-ja si parti e parë, por edhe VMRO-ja e cila ka dy ulëse më pak në Kuvend, por që ka thënë se tani më ka nisur konsultimet me partitë e tjera për sigurimin e numrave në Kuvend. Nga VMRO-ja nuk ka dhënë detaje duke theksuar se kryetari i partisë, Hristijan Mickovski, është i autorizuar nga organet partiake për udhëheqjen e negociatave. Kryetari i LSDM-së, Zoran Zaev,



ka bërë me dije se bisedimet për qeverinë e re do t'i nisë pas festës kombëtare të 2 gushtit. Bashkimi Demokratik për Integrim në zgjedhje mori pjesë me moton

"koha për kryeministrin e parë shqiptar", por zyrtarë të saj tani pas zgjedhjeve kanë theksuar se prioritet për këtë parti në negociatat për formimin e qeverisë

së re do të jenë zbatimi i tri marrëveshjeve: asaj me Greqinë për emrin, me Bullgarinë për fqinjësi të mira dhe Marrëveshja e Ohrit.

# Kosova blen automjete të blinduara nga ShBA-ja

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, ka bërë me dije se në Kosovë të shtunën ka arritur një kontingjent me automjete të blinduara nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) për FSK-në. Sipas tij, arritja e këtij kontingjenti ka të bëjë me një kontratë që Kosova e nënshkruar me ShBA-në vitin e kaluar

Kosova ka marrë donacion 27 automjete ushtarake të njëjta (Humvee) nga ShBA-ja, kurse para dy vjetësh është realizuar edhe një blerje prej 24 automjetesh.

Në 2018-n ndërmjet kompanisë amerikane AM General dhe Qeverisë së Kosovës u nënshkrua kontrata për pajisjen e FSK-së me 51 automjete të tipit Humvee. Sipas Ramës, blerjet e automjeteve të reja të blinduara u bënë bazuar në kërkesat dhe nevojat që ka FSK-ja. "Kjo po bëhet në bazën e ngritjes së kapaciteteve, por njëkohësisht është bazuar edhe në ligjet e reja, në mandatin dhe misionin e ri",

ka thënë Rama.

Në dhjetor të vitit 2018 Kuvendi i Kosovës miratoi ndryshimet ligjore për ta ndryshuar mandatin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK).

Kësaj force është thënë se do t'i nevojitet një periudhë kohore prej 10 vjetësh për t'u transformuar në ushtri me kapacitete të plota. Më herët është thënë se transformimi dhe ngritja e kapaciteteve të Forcës së Sigurisë së Kosovës pritet t'i kushtojë buxhetit të Kosovës nga 55 milionë euro në vit, sa ka qenë në vitin 2018, në afër 100 milionë euro në vit, diku pas 5 apo 6 vjetësh. Për transformimin e

FSK-së është planifikuar që buxheti për çdo vit të rritet nga 5.5 milionë euro, që deri më tani, sipas Ramës, kjo gjë është përkrahur.

Përgjegjësitë e reja të FSK-së kanë të bëjnë me ruajtjen e sovranitetit dhe integritetit territorial, qytetarëve, pronave dhe interesave të Republikës së Kosovës, si dhe mbështetje ushtarake për autoritetet civile dhe pjesëmarrjen në operacionet ndërkombëtare. Me planin gjithëpërfshirës të tranzicionit, planifikohet që numri i pjesëtarëve të FSK-së të arrijë në 5 000 pjesëtarë aktivë dhe 2 500 rezervë.

**PRISHTINË, 26 KORRIK** - Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, ka konfirmuar për "Radio Evropa e Lirë" se në Kosovë të shtunën ka arritur një kontingjent me automjete të blinduara nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës për FSK-në. Sipas tij, arritja e këtij kontingjenti ka të bëjë me një kontratë që Kosova e nënshkruar me ShBA-në vitin e kaluar. Ai shtoi se blerja e automjeteve të blinduara është bërë me buxhetin e Kosovës. "Është pjesa e dytë e kontingjentit që ka ardhur. Javën e kaluar ka ardhur një pjesë dhe tani është kompletuar. Bëhet fjalë për automjete të blinduara, tipit Humvee nga ShBA-ja", ka thënë Rama.

Gjenerallejtënant Rama, megjithatë, ka thënë se numri dhe kostoja e automjeteve tash për tash është informacion i klasifikuar, por ka shtuar se për këtë gjë mund të flitet në të ardhmen. Ai ka thënë se mund të priten edhe kontrata të tjera me ShBA-në. "Realisht, kjo është kontratë e klasifikuar. Mbi bazën e nevojave do të vazhdojmë edhe në të ardhmen. Në të gjitha

kontratat i kemi me ShBA-në edhe për sistem të armatimit edhe për këto automjete taktike. Edhe vitin e ardhshëm do t'i kemi (kontratat) e tjera", ka thënë Rama.

Rama ka shtuar se vitin e kaluar



## Përkujtohet polici Enver Zymeri



**PRISHTINË, 26 KORRIK (ER)** - Për nder të shënimit të përvjetorit të rënies në detyrë të heroit të Kosovës, Enver Zymeri, Policia e Kosovës të dielën ka realizuar aktivitete në shenjë përkujtimi dhe nderi për veprën dhe heroizmin e tij.

Në homazhe përkujtimore kanë marrë pjesë presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, kryeministri Avdullah Hoti, ministri i Punëve të Brendshme, Agim Veliu, drejtori i përgjithshëm i Policisë, Rashit Qalaj dhe menaxhmenti i lartë i PK-së, me ç'rast kanë vendosur kurora me lule te lapidari i heroit në kompleksin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë në Prishtinë. Të pranishëm në këtë ceremoni përkujtimore ishin edhe familjarë të heroit Zymeri. Pas homazheve dhe nderimit të heroit Zymeri, kryeministri Avdullah Hoti dhe ministri i

MPB-së, Agim Veliu, realizuan një takim zyrtar me drejtorin e përgjithshëm të Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, ku diskutuan për situatën e sigurisë në vend dhe menaxhimin e situatës gjatë pandemisë Covid-19.

Më pastaj drejtori Qalaj vazhdoi realizimin e një takimi me menaxhmentin e lartë të PK-së, drejtorët e Departamenteve dhe Drejtorive Rajonale, ku temë diskutimi e këtij takimi ishte situata e sigurisë dhe menaxhimi ndaj pandemisë. Drejtori Qalaj edhe një herë kërkoi angazhim shtesë dhe rritje të mëtejme të masave dhe veprimeve policore në terren, me qëllim të parandalimit të rritjes së rasteve të pandemisë, ruajtjes së shëndetit publik dhe ndërmarrjen së masave ndaj atyre që nuk respektojnë masat dhe vendimet e qeverisë.



Flet për “Epokën e re”, Bilall Sherifi

# Raportuesja Viola Cramon thotë të pavërteta për mandatin e Gjykatës Speciale

Sekretari i Përgjithshëm i Nismës Socialdemokrate, Bilall Sherifi, e ka quajtur skandal vizitën e raportueses për Kosovën në Parlamentin Evropian, Viola von Cramon, në Gjykatën Speciale. Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, ai ka vlerësuar se ajo ka thënë të pavërteta për mandatin e kësaj gjykate pas vizitës që i ka bërë në Hagë. Sherifi ka bërë me dije se ajo ka dezinformuar kur ka thënë: “Gjykata do të sjellë drejtësi në Kosovë ndaj atyre personave që besohet se kanë kryer krime lufte pavarësisht prej kombësive të tyre”. Sipas tij, nëse Von Cramon nuk e di që Gjykata Speciale do t’i dënojë vetëm shqiptarët, ajo duhet të kërkojë falje

dënojë vetëm shqiptarët, ajo duhet të kërkojë falje. “Nëse vërtet nuk e di që kjo gjykatë do të sjellë përpara bankës së akuzës ‘vetëm pjesëtarë të kombësisë shqiptare’, atëherë ajo nuk meriton të jetë raportuese për Kosovën në Parlamentin Evropian. Nëse vërtet nuk ka qenë e informuar për këtë çështje, atëherë ajo duhet të kërkojë falje publike për dezinformimin që ka bërë duke përhapur të pavërteta për gjoja paanshmërinë etnike të kësaj gjykate”, ka thënë ai. Sherifi ka folur edhe për rifillimin e dialogut të Brukselit në mes të Kosovës dhe Serbisë. Sipas tij, takimi i parë në mes të kryeministrit të Kosovës dhe presidentit të Serbisë ka qenë dialog para dialogut. “Nëse do të duhet ta përkufizojmë takimin e lartpërmendur, atëherë ai mund të cilësohet si ‘dialog para dialogut’. Ajo që

është thelbësore për takimet e kësaj natyre lidhet me domosdoshmërinë e qartësisht nëse njohja reciproke e dy shteteve do të jetë epilog i këtij dialogu. Në të kundërtën, do të kemi përsëritje të asaj që kemi parë që nga viti 2011”, është shprehur ai. Sherifi ka folur edhe për mospajtimet e partnerëve të koalicionit rreth koordinitorit shtetëror për dialogun e Brukselit. Sipas tij, mospajtimet kanë të bëjnë me mandatin e koordinitorit dhe jo me emrin e Skender Hysenit. “Kryetari i Nismës, Fatmir Limaj, ka sqaruar se mospajtimet tona lidhen me mandatin e koordinitorit dhe jo me emrin e Skender Hysenit. Kjo çështje diskutohet në nivele më të larta partiake ndërmjet kryetarëve të partive, njëherësh edhe me

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 26 KORRIK - Sekretari i Përgjithshëm i Nismës Socialdemokrate, Bilall Sherifi, e ka kritikuar vizitën e raportueses për Kosovën në Parlamentin Evropian, Viola von Cramon, në Gjykatën Speciale. Ai ka thënë se kjo vizitë përbën skandal. Në këtë intervistë dhënë për gazetën

“Epoka e re”, Sherifi ka vlerësuar se Viola von Cramon ka thënë të pavërteta për mandatin e kësaj gjykate pas vizitës. “Ajo u përpoq që vizitën e vet ta arsyetojë me mandatin që ka si raportuese e PE-së për Kosovën, por ende nuk e ka dhënë asnjë shpjegim se çka kishte parasysh kur tha: ‘Gjykata është duke bërë punë të jashtëzakonshme për të sjellë drejtësi në Kosovë ndaj

atyre personave që besohet se kanë kryer krime lufte, pavarësisht prej kombësive të tyre’. Të gjithë e dimë se shprehja ‘pavarësisht prej kombësive të tyre’ nuk është e vërtetë. Këtë duhet ta dijë edhe zonja Viola von Cramon”, ka thënë Sherifi. Ai ka deklaruar se nëse raportuesja për Kosovën në Parlamentin Evropian nuk e di që Gjykata Speciale do t’i

kritik ndaj tendencës që të "rrëshqitet" siç thoni ju, në "dialog teknik". Ku qëndrojnë arsyet e një qëndrimi të tillë?

**Bilall Sherifi:** Në takim me z. Hoti shpreha shqetësimet e Nismës Socialdemokrate për rreziqet që do të ngërthente realizimi i një hipoteze të tillë. Arsyet e qëndrimit tonë janë të qarta dhe kuptohen lehtë: Të gjithë e dimë se rezultati i dialogut teknik nuk ka sjellë as normalizim të marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve, as njohje reciproke. Përkundrazi. Serbia e ka shfrytëzuar këtë formë të dialogut për të zbatuar një fushatë të përmasave ndërkombëtare për çnjohjen e shtetësisë së Kosovës dhe, fatkeqësisht, kanë pasur sukses te një numër shtetesh që kanë tërhequr njohjet e tyre. Nëse BE-ja nuk ka një ide të qartë se si ta bindë Serbinë që ta njohë shtetin e Kosovës, atëherë Kosova nuk e ka asnjë arsye të rifikojë një proces të dialogut që nuk garanton njohjen nga Serbia.

**"Epoka e re":** Nisma është ankuar se nuk është konsultuar nga kryeministri për zgjedhjen e Skender Hysenit koordinator shtetëror për dialog. A e përkrahni z. Hysenin për koordinator?

**Bilall Sherifi:** Kryetari i Nismës, z. Fatmir Limaj, ka sqaruar se mospajtimet tona lidhen me mandatin e koordinatorit dhe jo me emrin e Skender Hysenit. Kjo çështje diskutohet në nivele më të larta partiake ndërmjet kryetarëve të partive, njëherësh edhe me kryeministrin e vendit. Shpresoj që të mbizotërojë arsyeja dhe të dalim sa më të fuqishëm në sfidat që na presin.

**"Epoka e re":** Qeveria Hoti po i bën dy muaj qëkur e ka marrë mandatin. Cili është vlerësimi juaj për këtë qeveri, a po i përmbush pritjet e Nismës?

**Bilall Sherifi:** Mendoj se deri më tani është brenda pritjeve tona. Natyrisht se gjithnjë ka vend për kritika, por jo të atij niveli ku mund të vihet në dilemë funksionimi i kësaj qeverie.

**"Epoka e re":** Derisa Kosova pritet të përballet me proceset shumë të rëndësishme, si dialogu me Serbinë, Gjykatën Speciale, qeveria aktuale duket e brishtë në numra. Mund të vazhdojë kjo qeveri të përballet me këto sfida apo e shihni si mundësi zgjerimin e koalicionit?

**Bilall Sherifi:** Pajtohem me ju kur thoni se Kosova pritet të përballet me sfida të rënda. Si dialogu, Gjykata Speciale, tani edhe përkeqësimi i gjendjes me Covid-19 që ndikon drejtpërdrejt në marrëdhëniet e

# Trumpi rifiton zgjedhjet 2020



**Shkruan: Seremb GJERGJI**

Presidenti Trump në shikim të parë duket se është person i veprimeve të shpejta dhe të pamatura mirë. Por, kjo vjen për dy arsye: 1. Trump e do Amerikën më shumë se cilido president deri më tash; dhe 2. Vepron me mendjen e një biznesmeni. Kjo i jep atij një avantazh të jashtëzakonshëm. Si shqiptar, e di që krejt të rinjtë me origjinë shqiptare në Amerikë, madje edhe disa prindër të tyre do ta votojnë Trumpin. Vlera e kapitalit njerëzor.

Presidenti Trump me veprimet e tij tregon se është i vetmi që mund ta sjellë ndryshimin e shumëpritur në Amerikë dhe në botë. Por, bota nuk është mësuar deri me tash e, ndoshta, as nuk është gati ta ndjekë Trumpin me hapat e tij gjigantë. Prandaj, frikësohen të gjithë. Natyrisht se duhet të frikësohen, sepse nëse nuk e mbajnë hapin, mbeten mbropa. Këtë e konfirmon edhe CNN Politics në një artikull debatues me James Wodds.

Tash sa vjet asnjë anketë në Amerikë nuk ka dalë e saktë. Të verbër do të jenë ata që e besojnë një të tillë sot. Aktualisht gjithçka varet nga vlera e kapi-

talit njerëzor dhe orientimi i tyre derë më derë. Andaj, fushata e presidentit Trump, duke u ikur këtyre anketave, sipas gazetës "Guardian", në vjeshtë do ta ketë një rikthim grandioz.

Si shikues evropian, kemi mendime të ndryshme, por z. Trump vërtet e ka bërë Amerikën madhështore përsëri. Ka rritur ekonominë amerikane në mënyrë rekorde. Tregjet botërore, po ashtu. Ka forcuar ushtrinë. Ka krijuar Ushtrinë e Qillit - se s'ka vend për toke më! Plot vende të reja pune të pafundme dhe ka kthyer prodhimin vendor. Ku ka më madhështore se kjo?! Është ëndërr e çdo qeverie të botës.

Krahasuar me pesë presidentët e fundit amerikan, Trumpi del diametralisht më i mirë se të gjithë. Madje më i mirë se edhe vetë Bill Clintoni, edhe pse ne si kosovarë kemi debulesë për presidentin Clinton. Në këtë garë Trumpi fiton 82:18 sepse amerikanët besojnë se Trumpi me të gjitha impulset e shpejta, të pamatura dhe reagimeve rigoroze vazhdon të mbetet i vetmi president që realisht sjell ndryshime. Askush tjetër.

Madje çdo amerikan, i pyetur se me cilin president kishit pasur dëshirë të pini një birrë, të gjithë përgjigjen me presidentin Trump. Asnjë president tjetër. Secili për të diskutuar hallet e veta, për ta lavdëruar, për ta fyer, për ta kritikuar e, madje, edhe për t'u munduar për ta nënçmuar. Por, vazhdon të mbetet i

vetmi në zemrat e tyre që ta kenë shansin ta pinë një birrë. Mendoj se kjo vjen nga fakti se secili amerikan e gjen veten në reagimin njerëzor të presidentit Trump - ngjashëm si gjithë njerëzit. Nuk shohin taktika politike me agjenda të fshehura. Në çdo anketë apo parashikim të mediave të majta, liberale apo të qendrës, mundohen të reflektojnë që Joe Biden është afër apo në epërsi. Por, tashmë botërisht, anketat kanë marrë fund. Në Amerikë dhe tek amerikanët anketat kanë dështuar aq shumë sa Gallup Internacionali - si kompania më e besueshme e anketave në botë, ka ngrehur duart.

Sot anketa më e mirë është biseda drejtpërdrejt me njerëz - diçka që presidenti Trump dhe ekipi i tij e bëjnë për mrekulli. Madje nuk duhet harruar edhe armën e tij më të fuqishme, zv/presidenti Mike Pence. Personi më i mençuri deri më tash në politikën amerikane dhe i vetmi person që askush nuk e ka gjetur asnjë gabim në jetën e tij, që nga dita kur ka lindur e deri më sot apo është aq i mençur që nuk ka lënë asnjë gjurmë.

Lehtë mund të themi, presidenti Trump do të rizgjidhet edhe një mandat këtë vjeshtë. Sipas profesorit të mirënjohur Helmut Norpoth, i cili ua ka qëlluar pesë fitoreve të fundit presidenciale në Amerikë, thotë se 91 për qind është shansi i fitores së sërishme të presidentit Donald Trump.

kryeministrin e vendit. Shpresoj të mbizotërojë arsyeja dhe të dalim sa më të fuqishëm në sfidat që na presin", ka deklaruar Sherifi.

**"Epoka e re":** Z. Sherifi, tashmë ka rifilluar procesin e dialogut me Serbinë në Bruksel. Cili është mendimi juaj për këtë takim?

**Bilall Sherifi:** Po, javën që shkoi në Bruksel është mbajtur një takim ndërmjet kryeministrit të Kosovës, Avdullah Hoti, dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Mirëpo ende nuk mund ta quajmë rifillim të dialogut ndërmjet dy shteteve. Nëse do të duhet ta përkufizojmë takimin e lartpërmendur, atëherë ai mund të cilësohet si "dialog para dialogut". Ajo që është thelbësore për takimet e kësaj natyre lidhet me domosdoshmërinë e qartësimin nëse njohja reciproke e dy shteteve do të jetë epilog i këtij dialogu. Në të kundërtën, do të kemi përsëritje të asaj që kemi parë që nga viti 2011. Ajo që dëshiroj të theksoj për lexuesit e "Epokës së re" lidhet me vendosmërinë e spektrit të gjerë politik në Kosovë që të mos lejohet që ky dialog të rrëshqasë në kornizat e një dialogu teknik për çështjet thelbësore politike.

**"Epoka e re":** Në takim me kryeministrin Hoti ju ishit

tërësishme shoqërore dhe ekonomike.

Nisma Socialdemokrate e Kosovës nuk është kundër zgjerimit të qeverisjes me të gjithë ata që janë të interesuar të kontribuojnë që të dalim fitimtarë në të gjitha sfidat që kemi përballë, mirëpo kjo çështje u takon forcave politike dhe liderëve të tyre nëse do të udhëhiqen nga një qasje prej burrështetasve që tejkalon këndvështrimin e ngushtë partiak apo do të vazhdojnë të udhëhiqen nga interesa vetëm partiake.

**"Epoka e re":** Nisma pas daljes së deputetit Haxhi Shala në AAK, ka mbetur pa grup parlamentar. Do të vazhdoni të veproni në Kuvend pa grup parlamentar apo synoni ta riktheni grupin parlamentar?

**Bilall Sherifi:** Mbi 42 mijë votues të koalicionit Nisma-

AKR kanë vendosur që në legjislaturën e re ky koalicion të përfaqësohet me grup parlamentar. Deputetët e kanë për detyrë që zërin e tyre ta përcjellin në Kuvendin e Kosovës qoftë duke funksionuar si grup parlamentar qoftë si deputet veç e veç.

**"Epoka e re":** Cili është koment juaj për vizitën e raportueses për Kosovën në Parlamentin Evropian, zonjës Viola von Cramon, në Gjykatën Speciale në Hagë. Ajo e arsyetoi vizitën e saj?

**Bilall Sherifi:** Unë sapo e pashë njoftimin e saj në "Twitter", reagova ndaj kësaj vizite, prandaj vazhdoj të konsideroj që vizita që ajo i ka bërë Gjykatës Speciale përbën skandal. Ajo u mundua vizitën e saj ta arsyetonte me mandatin që ka si raportuese e PE-së për Kosovën, por ende nuk e ka

dhënë asnjë shpjegim se çka kishte parasysh kur tha: "Gjykata është duke bërë punë të jashtëzakonshme për të sjellë drejtësi në Kosovë ndaj atyre personave që besohet se kanë kryer krime lufte, pavarësisht prej kombësive të tyre". Të gjithë e dimë se shprehja "pavarësisht kombësive të tyre" nuk është e vërtetë. Këtë duhet ta dijë edhe zonja Viola von Cramon. Nëse vërtet nuk e di që kjo gjykatë do të sjellë përpara bankës së akuzës "vetëm pjesëtarë të kombësisë shqiptare", atëherë ajo nuk meriton të jetë raportuese për Kosovën në Parlamentin Evropian. Nëse vërtet nuk ka qenë e informuar për këtë çështje, atëherë ajo duhet të kërkojë falje publike për dezinformimin që ka bërë duke përhapur të pavërteta për gjoja paanshmërinë etnike të kësaj gjykate.

Në dyvjetorin e vdekjes përkujtohet simboli i rezistencës kombëtare, Adem Demaçi

# Adem Demaçi gjithmonë do të mbetet në kujtesën e kombit shqiptar

Simboli i rezistencës kombëtare për liri, pavarësi të Kosovës dhe bashkim kombëtar, Adem Demaçi, ishte njeriu që sakrifikoi gjithçka për të jetuar ne sot të lirë, të pavarur dhe sovran. Kështu kanë thënë të dielën në dyvjetorin e vdekjes së Demaçit përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës, të Shqipërisë dhe liderët e partive politike



**EPOKA ERE**

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 26 KORRIK - Me rastin e dyvjetorit të vdekjes së veprimtarit të çështjes kombëtare, Adem Demaçi, përfaqësues të institucioneve të Kosovës, të Shqipërisë dhe liderë partish kanë thënë se Adem Demaçi sakrifikoi gjithçka për të jetuar ne sot të lirë, të pavarur dhe sovranë. Në dyvjetorin e vdekjes së Demaçit, presidenti Hashim Thaçi të dielën ka bërë homazhe te varri i tij. Thaçi ka thënë se vlera e rezistencës së Adem Demaçit është vlera e bashkimit të kombit, është vlera që i ka dhënë fuqi lirisë tonë, luftës për çlirimin e vendit.

Ai ka thënë se Demaçi do të mbetet gjithmonë në kujtesën e kombit, i nderuar dhe i respektuar si njeriu i lirisë dhe pavarësisë së Kosovës. "Sot me rastin e dyvjetorit të vdekjes nderojmë simbolin e rezistencës kombëtare për liri, për pavarësi të Kosovës dhe bashkim kombëtar, Adem Demaçin, njeriun që sakrifikoi gjithçka për të jetuar ne sot të lirë, të pavarur, sovranë dhe në rrugëtim të sigurt për të qenë pjesë e NATO-s dhe BE-së. Prandaj vlera e rezistencës së Adem Demaçit është vlera e bashkimit të kombit, është vlera që i ka dhënë fuqi lirisë sonë, luftës për çlirimin e vendit. Do të mbetet gjithmonë në kujtesën e kombit, i nderuar dhe i respektuar si njeriu i lirisë dhe pavarësisë së Kosovës. Adem Demaçi është njeri i paharrueshëm, është njeri i pazëvendësueshëm, është njeri i të sotmes, i simbolit të së kaluarës dhe, para së gjithash, i energjive të ardhmes", ka thënë presidenti Thaçi.

Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka thënë se Adem Demaçi ishte emblema e qëndresës shqiptare. "Nuk do t'i gjej kurrë fjalët e duhura për ta shprehur dhimbjen e thellë që la pas ikja jote në

përjetësi dy vjet më parë, baca Adem Demaçi, emblema e qëndresës shqiptare, heroi ynë i pashembullt për liri dhe dinjitet kombëtar e njerëzor. Sot ne përulemi me respekt e mirënjohje të thellë para kujtimit të jetës dhe veprës tënde të lavdishme e frymëzuese për të gjitha gjeneratat e shqiptarëve, si një model kombëtar i skalitur në historinë tonë dhe të luftës për pavarësinë e Kosovës", ka thënë Meta.

Kryeministri Avdullah Hoti, duke kujtuar Adem Demaçin në dyvjetorin e vdekjes, ka thënë se sakrificat e tij është dëshmia më e mirë e rrugëtimin tonë për liri e pavarësi. Ndërkaq lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë se Adem Demaçi ishte ndër personat më frymëzues e formësues për të dhe LV-në. "Adem Demaçi i përjetoj tri jugosllavitë dhe hyri tri herë në burg. 28 vjet gjithsej i kaloi si i burgosur politik. Kur e liruan në prill 1990, tha se po del nga burgu i vogël në burgun e madh. Vazhdoi veprimtarinë politike pa pushim e kursim për veten", ka thënë Kurti, duke shtuar se Demaçi kurrë nuk u step prej frikës, kurrë nuk u mposht prej dhimbjes, kurrë nuk u ligështua prej trysnisë. "Me thjeshtësi e qartësi të madhe intelektuale, me lakonizmin karakteristik, ai gjithnjë thoshte të vërtetën. Kjo cilësi iu njoh e iu vlerësua edhe nga Parlamenti Evropian, që i akordoi Adem Demaçit çmimin prestigjioz 'Saharov' për lirinë e të menduarit. Shkroi, tha e bëri aq shumë gjëra me peshë të rëndë politike, shoqërore e letrare, ndonëse tentativat për ta kufizuar, penguar e censuruar kurrë nuk munguan. Përballë Rankoviçëve, Titoistëve e Millosheviçëve, ky njeri shpirtmadh e mendjefortë, foli e tha të vërtetën universale të lirisë. E tha për popullin shqiptar, sepse këtij populli i ra për hise, falë Zotit,

një vigan i tillë. Sot, kur mendojmë, mendojmë edhe a thua çka do të mendonte ai. Prandaj, kur veprojmë, veprojmë sikur edhe ai të ishte me neve", ka thënë Kurti.

Edhe kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Isa Mustafa, ka përkujtuar veprimtarin Adem Demaçi në dyvjetorin e ndarjes nga jeta. Mustafa ka thënë se Adem Demaçi ishte veprimtar i pathyeshëm i çështjes kombëtare. "Me vullnet të pashembullt sakrifikoi pjesën më të madhe të jetës së tij nëpër burgjet e regjimit okupator, në shërbim të kauzës kombëtare për liri. Ai mbetet sinonim i flijimit dhe sakrificës për atdhe, duke u dergjur burgjeve serbe gati tri dekada, prandaj është model i njeriut të pathyeshëm për kauzën e lirisë. Me veprimtarinë e tij u bë simbol i sakrificës dhe rezistencës për liri, duke motivuar breza të tërë që të mos heqin dorë nga lufta e drejtë për liri dhe pavarësi", ka thënë Mustafa.

Ai ka theksuar se kontributi dhe sakrificat e Adem Demaçit, në kohët më të vështira për shtetin tonë, ishin frymëzim për të punuar

në arritjen e synimeve tona për krijimin e shtetit të pavarur dhe sovran të Kosovës. "I përjetshëm kujtimi për simbolin e rezistencës kosovare, Adem Demaçi", ka deklaruar Mustafa.

Kryetari i PDK-së, Kadri Veseli, ka thënë se Adem Demaçi ka thënë se me sakrificat e pandalshme për liri dhe me gatishmërinë e vazhdueshme për ta kundërshtuar robërinë, e ka shquar qysh moti Kosovën në hartën e Evropës si vend i veçantë që nuk e duron robërinë, por e aspiron lirinë dhe pavarësinë. "Te përkushtimi i Bacës Adem kurrë nuk duhet të heqim dorë nga liria. Gjeneratat e reja gjenin shembullin më sublim. Tek bindja e tij se nuk ka liri pa flijim, gjenerata të shumta nxorën mësimin më kuptimplotë. Guximi i tij që kurrë të mos ndalet, ishte inspirim që të tjerët të vazhdojnë gjithmonë. Krenar që e kishim gjithmonë shembull Bacën Adem", ka thënë Veseli.

Kreu i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka kujtuar veprimtarin Adem Demaçi në

dyvjetorin e vdekjes. "Dy vjet pa Bacën Adem. Vizionar e frymëzues. Luftëtar që zjarrin e lirisë, të trashëguar nga rilindësit e përcolli te ne, brezi i UÇK-së. Rruga e tij jetësore është vetë rruga e lirisë së Kosovës. Lavdi e përjetshme!", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook". Edhe kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka përkujtuar Adem Demaçin në dyvjetorin e ndarjes nga jeta. Ai e ka vlerësuar lart jetën dhe veprën e simbolit të rezistencës kombëtare, Adem Demaçi. "Dy vjet pa një nga veprimtarët më të shquar të çështjes kombëtare dhe simbolin e rezistencës kombëtare, Adem Demaçin. Baca Adem ishte dhe mbetet udhërrëfyesi më i mirë për djemtë dhe vajzat e reja që duan ta nderojnë vendin dhe kombin e vet. Ai qëndroi i pathyer prapa grilave për gati tri dekada, në mbrojtje të së drejtës për liri dhe pavarësi, ruajtjes së identitetit kombëtar shqiptar në ish-Jugosllavi. Qytetarët e Kosovës për jetë e mot gjithmonë do ta nderojnë dhe kujtojnë jetën dhe veprën e bacës Adem", ka thënë Limaj.

# Kosova regjistron edhe 8 viktima dhe 220 raste me koronavirus



Gjatë 24 orëve të fundit, në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik me metodën RT-PCR, janë testuar gjithsej 472 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren prej të cilëve rezultojnë 220 raste pozitive me Covid-19. Deri më tash numri total i rasteve pozitive është 7137 raste nga 34 316 persona të dyshimtë, me gjithsej 177 raste të vdekjes të cilët thuhet se kanë pasur sëmundje të tjera shoqëruese

shtretër kanë mbetur në dispozicion për personat e infektuar me koronavirus. Ai ka thënë se aktualisht institucionet përkatëse janë duke punuar në riorganizim të ri në QKUK dhe, ndoshta, mbylljen e disa klinikave për t'i shfrytëzuar më pas ato për personat e prekur me koronavirus.

## 756 profesionistë shëndetësorë janë infektuar me Covid-19 në Kosovë

Që nga regjistrimi i rasteve të para të Covid-19 në Kosovë (13 mars 2020) e deri më sot, 756 profesionistë shëndetësorë janë prekur nga ky infeksion (brenda dhe jashtë institucioneve shëndetësore). Lajmin e ka bërë me dije drejtori i Departamentit për Informim në Ministrinë e Shëndetësisë, Faik Hoti. "Këtë javë kemi humbur tre profesionistë të nderuar të mjekësisë së Kosovës: profesorin Sylejman Rexhepi, kirurgun Ali Tolaj dhe mjekun familjar Fadil Zuka. Personeli shëndetësor nuk ka nevojë që të

## Nga këto komuna janë rastet e reja me Covid

Komuna Prishtinë prin me më së shumti raste, veç për 24 orë ka 81 raste të reja me Covid-19. Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 81 raste, komuna Pejë 23 raste, komuna Ferizaj 13 raste, komuna Podujevë 12 raste, komuna Fushë Kosovë 10 raste, komuna Lipjan 9 raste, komuna Drenas 7 raste, komuna Gjakovë 7 raste, komuna Istog 6 raste, komuna Gjilan 6 raste, komuna Deçan 6 raste, komuna Viti 5 raste, komuna Vushtrri 4 raste, komuna Kamenicë 4 raste, komuna Suharekë 4 raste, komuna Klinë 4 raste, komuna Malishevë 4 raste, komuna Obiliq 4 raste, komuna Shtime 3 raste, komuna Skenderaj 3 raste, komuna Prizren 2 raste, komuna Rahovec 2 dhe komuna e Mitrovicës me 1 rast.

tjerët t'i tregojnë si ta bëjnë punën. Ai ka nevojë që secili të bëjë kujdes maksimal, t'i zbatojë masat e thjeshta, si: bartjen e maskës, ruajtja e distancës (fizike) dhe higjienën. Kështu atyre u lehtësohet puna", ka shkruar Hoti. Ai ka theksuar se humbja e çdo

mjeku/infermieri apo profesionisti tjetër shëndetësor na bën të gjithëve më të ekspozuar dhe më të pambrojtur para këtij virusi që nuk njih moshë, gjini, profesion, pozitë apo opozitë dhe që infektion e vret pa mëshirë.

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 26 KORRIK - Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë regjistruar edhe tetë viktima të reja dhe 220 raste me Covid-19. Ky rezultat vjen pas testimit të 472 mostrave. Deri më tash, numri total i rasteve pozitive është 7 137 raste nga 34 316 persona të dyshimtë, me gjithsej 177 raste të vdekjes të cilët thuhet se kanë pasur sëmundje të tjera shoqëruese. Ndërkaq, 121 pacientë janë shëruar nga koronavirusi, duke e çuar numrin total të të

shëruarve në 3 874. Numri i rasteve aktive me Covid-19 është 3 086.

Në Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës janë duke u trajtuar 564 raste, prej tyre 354 të konfirmuar me Covid-19 të shtrirë në klinika dhe spitale rajonale. Prej tyre, 353 me oksigjenoterapi, ndërkaq 17 në respiratorë dhe 18 në ventilim mekanik.

Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka bërë me dije të shtunën, në një konferencë për media, se nga gjithsej shtatëqind shtretër në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe në spitalet rajonale, vetëm edhe 130

## Mustafa kërkon përkrahje ndaj qeverisë për procesin e dialogut

Prishtinë, 26 korrik (ER) - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka thënë të dielën, në një shkrim publikuar në llogarinë e vet në "Facebook", se ka biseduar me Koordinatorin Shtetëror për Dialog, Skender Hyseni, rreth procesit të dialogut me Serbinë. Mustafa ka thënë se dialogu është krejtësisht politik dhe rezultojnë me marrëveshje politike ndër-

shtetërore për njohje reciproke. "Sot kisha një bisedë telefonike me Skender Hyseni, Koordinator Shtetëror për Dialog. Shpreha përkrahjen time dhe të LDK-së për kursin se nuk ka asnjë marrëveshje të veçantë jashtë marrëveshjes gjithëpërfshirëse që rezultojnë me njohje reciproke", ka thënë ai. Mustafa ka theksuar se për këtë proces duhet të ketë bashkëpunim ndërinstitu-

cional dhe të të gjithë aktorëve politikë. "Në këtë proces duhet dhënë përkrahje të fuqishme kryeministrit Hoti, qeverisë, presidentit si dhe të gjithë mekanizmave shtetërorë që e çojnë përpara këtë dialog politik. Përgjegjësia për dialogun bie mbi koalicionin qeverisës, ndërkaq pronësia e dialogut i takon shumicës kushtetuese parlamentare dhe asnjë subjekt veç e veç", ka thënë Mustafa.





# Ekspertët e ekonomisë nuk e shohin zgjidhje afatgjatë për ekonominë tërheqjen e mjeteve nga Trusti

Njohësit e çështjeve ekonomike, Visar Vokri, Safet Gërxhaliu dhe drejtori i Odës së Afarizmit, Skender Krasniqi, kanë thënë se Qeveria e Kosovës ka mundur ta gjejë ndonjë alternativë tjetër për tejkalimin e krizës ekonomike dhe sociale të shkaktuar nga pandemia Covid-19 dhe jo të bëhet tërheqja e kursimeve nga Trusti Pensional

**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 26 KORRIK - Qeveria e Kosovës ka miratuar Projektligjin për rimëkëmbje ekonomike Covid-19, që në kuadër të këtij projektligji është inkorporuar edhe plotësimndryshimi i Ligjit për Fondet Pensionale të Kosovës, ku parashihet që qytetarët e Kosovës t'i tërheqin deri në 10 për qind të kursimeve të tyre pensionale.

Njohësit e çështjeve të ekonomisë, Visar Vokri, Safet Gërxhaliu dhe drejtori i Odës së Afarizmit, Skender Krasniqi, ka thënë se për

rimëkëmbjen ekonomike dhe sociale të shkaktuar nga pandemia Covid-19, është dashur të gjenden alternativa të tjera pasi, sipas tyre, nuk është zgjidhje afatgjatë tërheqja e kursimeve nga Trusti Pensional.

Visar Vokri, ekonomist nga Instituti Riinvest, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se në kohë krizash kur ka rënie të kërkesës, ndërhyrje të tilla mund ta nxisin konsumin, por meqë s'mund të paragjykohej mënyra e shpenzimit të këtyre mjeteve, atëherë ka gjasa që këto mjete mos të shpenzohen për rimëkëmbje ekonomike. "Përmes

ndryshimeve ligjore që parashihen në projektligjin për rimëkëmbjen ekonomike Covid-19, qeveria parasheh edhe mundësinë që qytetarët e Kosovës të mund të tërheqin 10 për qind të kursimeve të tyre pensionale para pensionimit. Ky veprim është pjesë e masave që qeveria ka paraparë për rimëkëmbjen ekonomike të vendit dhe ka për qëllim rritjen e kërkesës agregate përmes futjes në qarkullim të rreth 200 milionë euro nga fondi i kursimeve pensionale. Në kohë krizash, kur kërkesa ka pësuar rënie, ndërhyrje të tilla që mund ta nxisin konsumin janë të mirëseardhura. Mirëpo, duke marrë parasysh supozimet që kjo masë ndërthet në vete, efekti druaj që do të jetë i papërfillshëm dhe kjo për disa arsye. Fillimisht, nuk dihet sa është shuma totale që do të tërhiqen nga fondi sepse jo të gjithë kontribuuesit do të duan të bëjnë një gjë të tillë. Pastaj, nuk duhet marrë për ta mirëqenë faktin që të gjitha paratë që do të tërhiqen nga

kursimet pensionale do të shkojnë në konsum", ka thënë Vokri.

Ai ka shtuar se në kohë krizash dhe pasigurish, ekonomitë familjare kanë tendencë ta reduktojnë konsumin e mallrave dhe shërbimeve joesenciale. "Gjithashtu, këtu duhet pasur parasysh edhe strukturën e kontribuuesve; 20 për qind e kontribuuesve kanë afërsisht tri të katërtat e të gjitha kontributeve në fondin pensional. Kjo kategori është kryesisht kontribuues me të ardhura të larta të cilët jo domosdoshmërisht do t'i tërheqin këto pjesë të kontributeve të tyre apo t'i shpenzojnë ato. Në rastin më të mirë, kjo kategori mund të shpenzojë këto sasi të kursimeve në të mira të luksit ku paraja nuk do të mbetet gjatë në Kosovë", ka thënë Vokri, duke shtuar se, nëse qëllimi i këtij veprimi të qeverisë do të ishte maksimizimi i efektit të kësaj sasive të re të parasë në ekonomi, atëherë një masë e tillë do të duhej t'i paraprinte

një sërë masave të tjera, kryesisht në anën e ofertës, të cilat do ta nxisin konsumin e prodhimit vendor. "Vetëm në këtë mënyrë paraja do të mund të mbetet më gjatë brenda dhe kështu do të prodhonte efekte të dukshme në ekonomi", u shpreh ai.

Sa i përket mundësisë së krijimit të një "precedenti të rrezikshëm", të tërheqjes së mjeteve, Vokri shprehet se qeveritë e ardhshme do të jenë të përgjegjshme dhe nuk do të përdorin këtë precedent si mundësi për t'i joshur kontribuuesit. "Ndryshimet ligjore të parapara me këtë projektligj janë të përkohshme dhe, si të tilla, janë në funksion të rimëkëmbjes ekonomike si pasojë e recesionit të shkaktuar nga kriza pandemike. Shpresoj se nuk do të kemi nevojë për ndërhyrje të tilla në të ardhmen edhe qeveritë e ardhshme do të jenë të përgjegjshme dhe nuk do të përdorin këtë precedent si mundësi për t'i joshur kontribuuesit duke ua





përkrahje të shtetit, por me vetpërkrahje të qytetarëve. Shteti do të duhej të krijonte përkrahje për qytetarët dhe bizneset për mbajtjen e vendeve të punës dhe për rritje të Fondit për Garantimin e Kredive, që ne kemi kërkuar që të jetë 300 mijë euro dhe që bizneset të kenë mundësi të marrin kredi me norma më të ulëta dhe më pas të investojnë. Fatkeqësisht, shteti është duke dështuar në përkrahje të bizneseve dhe ka dështuar shumë deri më tani. Ende s'ka kaluar as rishikimi i buxhetit dhe kemi një pako emergjente skajshmërisht të vonuar në implementim”, ka thënë Krasniqi.

Ai ka thënë se do të duhej që shteti të interesohej me urgjencë në përkrahje të punëtorëve, sidomos për ata që e kanë humbur vendin e punës dhe jo të merret me këso lojëra për tërheqje të mjeteve nga Trusti. “Kjo do të ketë pasoja në aspektin afatgjatë”, ka thënë Krasniqi.

Njohësi tjetër i çështjeve ekonomike, i cili është edhe sekretar gjeneral në Forumin Investiv të Odave Ekonomike të Ballkanit Perëndimor në Trieste të Italisë, Safet Gërxhaliu, ka apeluar tek institucionet e vendit që të gjejnë modalitete të tjera për rimëkëmbjen ekonomike. “Jemi dëshmitarë që agjenda politike është duke dominuar, por është agjendë e shfrenuar pasi s'ka unitet. Ligjvënësit duhet të jenë unikë rreth ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare, por edhe në votim të rishikimit të buxhetit”, ka thënë Gërxhaliu, duke shtuar se ka drojën që do të krijohet një precedent i rrezikshëm dhe se paratë e tërhequra nga Trusti nuk do të shfrytëzohen në mënyrën më ekonomike. “Është precedent që do ta rrezikojë qytetarinë dhe në një vend ku s'ka sundim të ligjit kam drojën që ajo para sërisht do të jetë shënjestra për kampanja apo interesa politike. Andaj, kam drojën që nëse vjen deri te ndryshimi i ligjit, paratë e tërhequra do të shfrytëzohen për pushime dhe pagesa pa kontrollë sesa në stabilitet”, ka thënë Gërxhaliu.

Një qytetarë nga Prishtina, Gentiana Krasniqi, e cila është e punësuar në sektorin privat, ka thënë se nisma për tërheqjen e kursimeve nga Trusti është e mirëseardhur. “Kjo nismë është e mirëseardhur dhe menjëherë do t'i tërheqë kursimet e mia. I kam rreth 400 euro. Këto mjete do t'i përdorë për nevojat elementare për vete dhe familjen, meqenëse që pesë muaj e kam marrë pagën e përgjysmuar dhe kam për të mbuluar disa shpenzime”, ka thënë Gentiana Krasniqi.

# Hoti: Ferronikeli, kompani e rëndësishme strategjike për Kosovën

**DRENAS, 26 KORRIK (ER) -** Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, në kuadër të vizitave që është duke ua bërë bizneseve private, për ta prezantuar pakon për rimëkëmbje ekonomike të Qeverisë së Kosovës, i shoqëruar nga ministri Blerim Kuçi dhe Vesel Krasniqi, ka vizituar ndërmarjen Ferronikeli, ku është prituar nga presidenti i Grupit Balfin, Samir Mane, me bashkëpunëtorë.

Në takim i pranishëm ishte edhe kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovi. Kryeministri Hoti ka thënë se gjatë kësaj vizite është biseduar për mbarëvajtjen e punëve në këtë kompani që është e rëndësishme strategjike për Kosovën për shkak të nivelit të lartë të eksporteve që ka komplet në gjithë prodhimin e saj. “Bashkë me ministrat dhe kryetarin e komunës, biseduam hollësisht për disa prej çështjeve që ne mund të adresojmë, të ndih-

mojmë këtë kompani, duke filluar nga renta minerare dhe një mbështetje që duhet t'i japim për të liruar një pjesë të minierave për ta shfrytëzuar për kompaninë. Sigurisht afarizmi i kompanisë varet nga tregu ndërkombëtar, nga çmimi i produktit në berëzën ndërkombëtare dhe duke pasur parasysh përvojën që z. Mane ka, unë besoj se mund të depërtojë në tregje të tjera”, ka deklaruar kryeministri Hoti.

Më tej, kryeministri Hoti ka theksuar se sa i përket qeverisë, bashkë me pushtetin lokal do ta ketë gjithë mbështetjen e nevojshme brenda ligjeve, brenda kornizës ligjore që na lejon për ta mbështetur këtë kompani edhe në kushte normale të funksionimit, në veçanti tash kur gjithë ekonomia në Kosovë dhe në regjion po përballet me vështirësi. “Besoj se në javët e ardhshme, si pjesë e Pakos për Rimëkëmbje Ekonomike, do ta

adresojmë çështjen e rentës minerare. Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit, bashkë me ZRRE-në, do të angazhohet sa i përket çmimit të energjisë elektrike, duke shfrytëzuar gjithë kornizën ligjore në fuqi që t'i jepet mbështetja e nevojshme kësaj kompanie”, është shprehur Hoti, duke shtuar se janë të nderuar me këtë investitor të rëndësishëm dhe të suksesshëm në tregjet ndërkombëtare, i cili ka zgjedhur të operojë edhe në Kosovë.

Presidenti i Grupit Balfin, Samir Mane, pasi ka falënderuar kryeministrin Hoti për vizitën, ka pohuar se koha nuk është më e mira për Ferronikelin, por ka theksuar se do të bëjnë atë që u takon për të depërtuar në tregun ndërkombëtar. Ai ka thënë se do të ishte mirënjohës që problemet e ngritura sot të adresohen aty ku duhet, siç duhet dhe në kohën e duhur.



mundësuar tërheqjen e parakohshme të kursimeve të tyre pensionale. Një veprim i tillë do të mund të shndërrohej në barrë sociale që do t'u faturohej gjeneratave të ardhshme”, u shpreh Vokri.

Ai ka thënë se sa i përket kësaj çështjeje, Kuvendi i Kosovës është para aktit të kryer dhe s'ka kohë për të humbur por, sipas tij, qeveria dhe ministrat e linjës mund të ndërhyjnë përmes masave të ndryshme në funksion të rimëkëmbjes ekonomike. “Kuvendi i Kosovës tashmë është para një akti të kryer ngaqë nuk ka kohë për të humbur. Ky ligj besoj se do të votohet, mirëpo kjo nuk e pengon qeverinë dhe ministrat e linjës që në mënyrë proaktive të ndërhyjnë përmes masave të ndryshme që mundësojnë maksimizimin e efektit të pakos së rimëkëmbjes dhe këtij ligji në ekonomi”, është shprehur ai.

Po ashtu, kryetari i Odës së Afarizmit, Skënder Krasniqi, ka shprehur skepticizëm lidhur me tërheqjen e mjeteve nga Trusti. “Si Odë e Afarizmit nuk e shohim këtë mundësi si zgjidhje afatgjatë, si për bizneset, po ashtu edhe për qytetarët. Pasi shuma që do të përfitojnë shumica e qytetarëve do të jetë e vogël 250-400 euro dhe kjo nuk është ndonjë zgjidhje që do t'u ndihmojë shumë atyre. Në këtë rast s'kemi të bëjmë me

## Përrurohet platforma elektronike për shërbime administrative 'E-kiosk' në Junik

JUNIK, 22 KORRIK (ER) - Komuna e Junikut nga sot përmes shërbimit elektronik 'E-kiosk' u mundëson qytetarëve marrjen e shërbimeve

administrative në çdo kohë. Qytetarët përmes platformës elektronike 'E-kiosk' mund t'i shkarkojnë dokumentet si: Certifikata e lindjes,

ekstraktin nga regjistri qendror, certifikatën e martesës, certifikatën e shtetësisë dhe certifikatën e vendbanimit. 'E-kiosku' do të jetë në shër-

bim të qytetarëve 24/7. Projekti është realizuar në kuadër të iniciativës "Shërbime të mira dhe lehtë të qasme për qytetarë".



## Lladrovci kërkon nga qytetarët që t'u përmbahen rekomandimeve të MSh-së dhe IKShPK-së

DRENAS, 26 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka folur për situatën e pandemisë Covid-19 në këtë komunë. Ai ka thënë se javët e fundit është rritur numri i rasteve të prekura me virusin Covid-19. "Fatkeqësisht, nga kjo rritje është prekur edhe komuna jonë. Kërkoj nga ju që me rigorozitet dhe disiplinë, pa përjashtim, t'i respektoni të gjitha masat e rekomandimet e Ministrisë së Shëndetësisë, Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike dhe institucioneve lokale. Për

rastet e rezultuara pozitive me virus kemi marrë masat e nevojshme për të siguruar që të mos ketë përhapje më të madhe", ka thënë Lladrovci. Ai ka pohuar se inspektorët komunalë, në bashkëpunim me policinë, janë vazhdimisht në terren dhe po monitorojnë gjendjen në Komunën e Drenasit. "Ju lutem shumë, mos kontribuoni në rritjen e numrit të rasteve, ruani shëndetin tuaj dhe të familjes. Vendosni maskën, aplikoni distancën fizike, kujdesuni për higjienën", ka thënë kryetari Lladrovci.



## Parku i qytetit në Kaçanik bëhet me minibibliotekë



Kaçanik, 26 korrik (ER) - Në hapësirat e parkut të qytetit në Kaçanik është bërë promovimi i minibibliotekës në qytet, iniciativë kjo e Klubit të Supërvullnetarëve Altruistët. Në këtë aktivitet mori pjesë edhe kryetari i Komunës së Kaçanikut, Besim Ilazi, i cili ka thënë se këto aktivitete po i japin jetë qytetit në këtë kohë të rëndë nga pandemia. Ilazi falënderoi të rinjtë për iniciativat e tyre, ndërsa uroi që këto aktivitete të vazhdojnë, duke premtuar përkrahje

të vazhdueshme institucionale. Kryetari Ilazi në mënyrë simbolike dhuroi disa libra për bibliotekën e re. Të pranishmit i falënderoi altruistja Dafina Trupi, e cila shprehu gëzimin e saj për realizimin e projektit. "Ne jemi tepër të gëzuar që kemi arritur ta pajisim qytetin tonë me një minibibliotekë të këtij lloji dhe që qytetarët tanë të kenë mundësi të shkëmbejnë libra dhe që të rritet kultura e leximit te ne", ka thënë Dafina.

## Punimet për zgjerimin e rrugës "Bardhyl Çausi" në Gjakovë drejt përfundimit

GJAKOVË, 26 KORRIK (ER) - Komuna e Gjakovës ka njoftuar se brenda një kohe të shkurtër qytetarët do ta kenë në shfrytëzim një rrugë moderne me të gjitha elementet që i takojnë. "Punimet për zgjerimin e rrugës 'Bardhyl Çausi' janë drejt përfundimit-

it. Kjo është zonë e rëndësishme e qytetit tonë, prandaj falë këtij projekti edhe qarkullimi për të gjithë ata që e frekuentojnë do të jetë më i lehtë. Puna në zgjerimin e rrugës është duke vazhduar", ka njoftuar Komuna e Gjakovës.



## Fshati Hogosht i Kamenicës së shpejti me rrjet të zgjeruar të mbeturinave

KAMENICË, 26 KORRIK (ER) - Komuna e Kamenicës, përkatesisht udhëheqësi i sektorit për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Ambientit, Hysen Jerliu, së

bashku me menaxheren e Njësisë "Ecohigjiena" në Kamenicë, Shejnaze Masurica, kanë mbajtur një takim me kryetarin e Këshillit Lokal të fshatit

Hogosht, Haqif Agaj, për të diskutuar në lidhje me zgjerimin e rrjetit të mbeturinave në këtë fshat. Deri tani mbi 90 për qind e qytetarëve të Hogoshtit

janë furnizuar me kontejnerë 120 litra dhe është duke u punuar në vazhdimësi që të arrihet mbulueshmëria në 100 për qind në këtë fshat.



# UÇK-ja ËSHTË NYJA E UNITETIT KOMBËTAR SHQIPTAR (17)



Shkruan: Kudusi LAMA

Pra, Kosova nuk kishte më asnjë alternativë për të jetuar në paqe duke ndërtuar të ardhmen për vete e për brezat që do të vinin. Kishte mbetur vetëm një alternativë që sillte me vete mjaft rreziqe. Ajo ishte lufta. Lufta u krye dhe prej saj lindi çlirimi për këtë popull të pushtuar, prej saj u arrit që kosovarët të mund të thonë para botës: "Kosova është jona. Kosova është truall shqiptar dhe e banuar historikisht prej shqiptarëve".

Por të mbajmë në vëmendje se për zgjidhjen e problemeve jetike, populli shqiptar asnjëherë nuk është shkëputur nga elementet ndërkombëtare. Nëse i referohemi historisë, vërejmë se kur shqiptarët kanë pasur probleme madhore gjithnjë kanë kërkuar përkrahjen e kombeve të tjera të Evropës. E kanë dhënë ose jo përkrahjen e tyre evropianët, kjo ka qenë diçka tjetër. Kombi ynë, gjithashtu, ka qenë edhe mburojë evropiane në të gjitha momentet e vështira të saj.

Në rastin e luftës në Kosovë mbështetja ndërkombëtare fillimisht ishte e dobët, për të mos thënë se nuk ekzistonte fare. Por kur u pa se në Kosovë ishte një ushtri që kishte marrë përsipër t'i çlironte trojet e popullit të vet, natyrshëm filloi të shfaqet edhe vëmendja ndërkombëtare.

Angazhimi në këtë zgjidhje solli mbështetjen për të cilën Kosova dhe ushtria e saj çlirimtare kishin shumë nevojë. Mbështetja që ishte jo vetëm evropiane, por mbështetje botërore nëpërmjet politikës në përgjithësi dhe NATO-s, në veçanti në disa plane ishte me vlera të pazëvendësueshme për zhvillimet në Kosovë, prej të cilave veçojmë: Së pari, arriti ta shkurtonte ndjeshëm kohëzgjatjen e luftës; së dyti, zvogëloi numrin e viktimave në popullin e Kosovës; zvogëloi numrin e të rënëve në luftë nga radhët e UÇK-së dhe zvogëloi numrin e të vrarëve nga radhët e ushtrisë dhe të policisë serbo-sllave; së treti, zvogëloi shkallën e dëmeve materiale në territorin e Kosovës; së katërti, shpëtoi pa u shkatërruar flora dhe fauna e Kosovës; së pesti, nuk lejoi që forcat ushtarake-policore serbo-sllave të minonin tërë territorin e Kosovës, praktikë kjo të cilën e filluan; së gjashti, nuk

lejoi që forcat ushtarake-policore serbo-sllave të shkatërronin plotësisht elementet historike dhe kulturore të Kosovës, gjë që e patën filluar; së shtati, në procesin e shpërnguljes së plotë nga Kosova, ndikoi në mbajtjen dhe në rritjen e moralit dhe të shpresës së popullit shqiptar, për arritjen e çlirimit të merituar; së teti, ndikoi në fuqizimin e shpejtë të UÇK-së; së nënti, e ktheu luftën e UÇK-së në luftë ndërkombëtare; së dhjeti, mbështeti mbijetesën e popullit të Kosovës në momentet e vështira të shpërnguljes së tij; së njëmbëdhjeti, krijoi kushte për rikthimin më të shpejtë të popullit të Kosovës në vendbanimet e tij.

Për këto faktorit ndërkombëtar do t'i jemi mirënjohës përjetësisht. Por duhet ta dijë se nuk e bëri vetëm për ne, por edhe për vete.

Në atë kohë Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së funksiononte si një qeveri e luftës dhe kishte mungesë njohurish dhe shumë vështirësi për ta realizuar ketë detyrë.

Por, Qeveria e Luftës vepronte realisht plotësisht pranë fronteve. Kjo Qeveri e Luftës ishte e detyruar të kryente detyra shumë të vështira dhe me dinamizëm maksimal. Prej saj kërkohej të ideonte, krijonte, organizonte dhe pajiste njësitë e UÇK-së. Prej saj kërkohej të ndërtonte moralin e luftës, të ndërtonte një politikë të pranueshme nga populli dhe nga politika ndërkombëtare; të siguronte mobilizimin e trupave ushtarake; të ushqente ushtrinë, t'i siguronte nevojat materiale të luftës, të bashkëpunonte me popullin, të edukonte trupat luftarake për domosdoshmërinë e luftës dhe të fitores, ta siguronte jetën e popullit të rrezikuar nga masat e dhunshme serbo-sllave, t'i siguronte pronat e popullit që kishte braktisur banesat; ta siguronte jetën e popullatës në male; ta siguronte bashkëpunimin me institucionet ndërkombëtare, të krijonte efikasitet udhëheqës të strukturave financiare, për ta siguruar vazhdimësinë e jetës dhe të luftës në Kosovë, për ushtrinë dhe popullin që jetonte në male, t'i krijonte dhe t'i udhëhiqte mediat në shërbim të luftës dhe të jetës në Kosovë; të ndërtonte rrugë dhe strehë, të vendoste rend dhe të organizonte shërbim informativ. Të gjitha këto duhet të kryeshin në kushtet e luftës, në kushtet e malit, në kushtet e terrenit, jashtë komoditetit dhe qetësisë, jashtë normalitetit dhe sigurisë. Megjithatë, faktet

treguan se edhe në këto kushte Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së arriti të bëjë atë për të cilën Kosova kishte më së shumti nevojë - ta siguronte çlirimin nga kolonializmi serbo-sllav.

Kjo Qeveri e Luftës, e cila vetëm pas Rambujesë u deklarua si Qeveri e Përkohshme e Kosovës, këto detyra i kishte kryer që nga themelimi i UÇK-së. Ky ekip simpatik asnjëherë nuk u ndal për realizimin e obligimeve për ardhmërinë e Kosovës. Asnjëherë nuk u trondit nga deklaratimet dhe nga angazhimi serbo-sllav për t'i zhdukur. Asnjëherë nuk u demoralizua nga dinamizmi i betejave të pabarabarta me forcat ushtarake-policore serbo-sllave. Detyrat e Shtabit të Përgjithshëm dhe përgjegjësia e tij në udhëheqjen e jetës së luftës ishin të mëdha. Përveç ngarkesës maksimale, ata kërkonin për çdo drejtues edhe një lëvizje të vazhdueshme, për të komunikuar me trupat, me popullin, me diplomacinë botërore dhe me politikën ndërkombëtare. Këto lëvizje nuk bëheshin me aeroplanë e as me automjete luksoze, por në këmbë, të ngarkuar edhe me armë e municione, si dhe në kushtet e rrezikut të vazhdueshëm të ndeshjes me armikun. Duhet ta mbajmë parasysh veçorinë e luftës në Kosovë, ku fronti mund të ishte gjithkund, armiku mund të ishte gjithkund, e papritura mund të ishte gjithkund, për shkak se lufta bëhej në një terren të cilin armiku e kishte pushtuar. Pikërisht, për këto shkaqe,

Ushtria Çlirimtare ishte e detyruar të ishte e kudondodhur dhe, për rrjedhojë, edhe drejtuesit e saj duhet të ishin të kudondodhur. E ardhmja do t'i japë vlerat reale të luftës çlirimtare të Kosovës. Ajo është autore e çlirimit të Kosovës, është autore e kthimit të vlerave kombëtare shqiptare në terrenet e mohuara, është autore e dinjitetit mbarëshqiptar, është simbol i qëndresës shqiptare, është pararoja e veprimtarisë për marrjen e të drejtave kombëtare nga të gjithë shqiptarët në gjithë trojet etnike në Ballkan, është pishtari i djegies përfundimtare të diktaturave, është shtrati i ecurisë kombëtare, është lavdia e historisë së Kosovës dhe i të gjitha trojeve shqiptare, është mburoja e të gjithë nevojtarëve dhe është ndihmëtarja e të pafuqishmëve.

UÇK-ja është nyja e unitetit kombëtar shqiptar.

UÇK-ja tregoi qartë se kombi shqiptar sado që të përpiqen ta zhbëjnë, ai vetëm forcohet, sado të përpiqen ta asgjësojnë - vetëm shtohet; sado të përpiqen ta djegin - vetëm pasurohet, sado të përpiqen ta shkatërrojnë - vetëm zbkurohet; sado të përpiqen ta përçajnë - vetëm bashkohet; sado të përpiqen ta injorojnë - vetëm burrohet; sado të përpiqen ta dhunojnë - vetëm armatoset.

UÇK-ja është krenaria jonë, guximi ynë, vlera jonë, floriri ynë, forca jonë.

Lufta Çlirimtare e Kosovës, vepra madhore shqiptare e fundshekullit të njëzetë, u paraqit si fat i madh për

shqiptarët, si pasqyrë e vullnetit, moralit, organizimit, atdhetarizmit, përkushtimit, unitetit, synimeve dhe objektivave të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e cila është përfaqësuesja më madhore e idealeve kombëtare shqiptare.

Prandaj të mbahet parasysh se prania dhe vlera e saj shihet edhe në përgjigjet që kërkohet t'u jepen këtyre pyetjeve: Së pari: Kush luftoi në Kosovë për mbi dy vjet me forcat ushtarake-policore serbo-sllave? Së dyti: Pse ranë rreth dy mijë dëshmorë në Kosovë? Së treti: Pse ndërkombëtarët në Konferencën e Rambujesë, vëmendjen kryesore e përqendruan në bindjen e përfaqësuesit të UÇK-së për bërteljen e paqes? Së katërti: Pse erdhi NATO-ja në Kosovë dhe kush ishte forca tokësore e saj? Së pesti: Me kë luftuan për mbi dy vjet forcat serbo-sllave në Kosovë? Së gjashti: Kush i vrau mijëra ushtarake serbo-sllavë në Kosovë, në vitet 1998-1999? Së shtati: Kush ishte pushteti i parë në Kosovë, pas Marrëveshjes së Rambujesë? Së teti: Me kë mbajti lidhje bota moderne në Kosovë deri në marrjen e pushtetit prej UNMIK-ut? Së nënti: Pse u deshtë të bëhej akti ndërkombëtar i çarmatosjes dhe shpërndarjes së UÇK-së nga NATO-ja dhe UNMIK-u? Së dhjeti: Pse duhet të mbyllej Millosheviqi në Hagë? Këto mos t'i harrojmë sa herë të na kujtohet Gjykata Speciale e themeluar nën presionin botëror për të na lodhur burrat që bën luftën. (Vijon)





# Borges në shtëpinë e tij: Politika është një nga format e mërzisë



**Nga: Mario Vargas Llosa**  
(intervistë e pabotuar e vitit 1981)

**Përktheu: Bajram Karabolli** (libri "Gjysmë shekulli me Borgesin")

Nëse do të më duhej të përmendja një shkrimtar në gjuhën spanjolle të kohës sonë, vepra e të cilit do të rrojë për të lënë një gjurmë të thellë në letërsi, do të citoja këtë poet, tregimtar dhe eseist argjentinas, që i dha mbiemrin e tij artistes së famshme Grasiela Borges\*, Jorge Luis Borges.

Një grusht librash që shkroi, gjithnjë libra të shkurtër, të përsosur dhe të çmuar si një unazë, ku njeriu ka përshtypjen se asgjë nuk mungon dhe asgjë nuk është e tepërt, kanë pasur dhe kanë një ndikim të madh tek ata që shkruajnë spanjisht. Tregimet e tij fantastike, të cilat zhvillohen në Pampa, në Buenos Aires, në Kinë, në Londër, në çdo vend të realitetit ose irealitetit, tregojnë të njëjtën imagjinatë të fuqishme dhe të njëjtën kulturë të frikshme sa edhe esetë e tij mbi kohën, gjuhën e vikingëve... Por erudicioni te Borges nuk është kurrë

diçka e dendur, akademike, por gjithnjë është diçka e pazakon-të, e shkëlqyeshme, argëtuese, një aventurë e shpirtit, prej nga ne lexuesit gjithmonë dalim të befasuar dhe të pasuruar. Intervista me Borgesin është zhvilluar në një apartament modest, në qendër të Buenos Airesit, ku ai jetonte i kujdesur nga një punonjëse, e cila i shërbente edhe si shoqëruese, pasi Borges kishte disa vjet që e kishte humbur shikimin; po ashtu i shoqëruar nga një maçok angora, të cilin e kishte pagëzuar me emrin Bepo, sepse, siç tha, ashtu quhej maçoku i poetit anglez, Lord Bajron, të cilin ai e admironte.

**Llosa: Më habiti shumë fakti që, duke parë bibliotekën tuaj, nuk gjeta libra tuajt. Pse nuk ka libra tuajt në bibliotekë?**

**Borges:** Kujdesem shumë për bibliotekën time. Kush jam unë që ta quaj veten njësoj me Shopenhauerin...

**Llosa: Dhe nuk ka as libra për ju, shikoj që nuk ka asnjë nga gjithë ata libra që janë shkruar për ju.**

**Borges:** Nga ata unë kam lexuar në Mendosa, të parin, të botuar

gjatë diktaturës.

**Llosa: Cila diktaturë, Borges? Sepse, për fat të keq, ka pasur kaq shumë...**

**Borges:** Ajo e atij... emrin e të cilit nuk dua ta kujtoj.

**Llosa: As mos e përmendni.**

**Borges:** Jo, as dua ta kujtoj. Ka fjalë të cilat është mirë t'i shmangësh. Epo, doli libri "Borges, enigma dhe çelësi", shkruar nga Ruis Dias (Ruiz Díaz), një profesor nga Mendosa, dhe nga një bolivian, Tamajo. Dhe e lexova atë libër për të parë nëse mund ta gjeja çelësin, pasi enigmën e njihja. Pastaj, nuk kam lexuar më asnjë tjetër. Alisia Hurado (Alicia Jurado) ka shkruar një libër për mua. E falënderova dhe i thashë: "Unë e di se është mirë, por tema nuk më intereson mua ose ndoshta më intereson shumë, kështu që nuk do ta lexoj."

**Llosa: Domethënë, nuk e keni lexuar as atë biografinë voluminoze që Rodrigues Monegali (Rodríguez Monegal) ka shkruar për ju.**

**Borges:** Dhe doni të thoni se

është shumë e mirë?

**Llosa: Së paku shumë e dokumentuar dhe realisht e bërë me një nderim të thellë, me një dashuri të madhe për ju, madje, besoj, me njohuri të mëdha për veprën tuaj.**

**Borges:** Po, jemi miq. Ai është nga Melo, apo jo? Nga Uruguai.

**Llosa: Po, dhe, gjithashtu, në një nga tregimet tuaja paraqitet si personazh.**

**Borges:** Për qytetin Melo mbaj mend disa vargje shumë të këndshme të Emilio Oribes, të cilat fillojnë në një mënyrë pa shumë vlerë, por pastaj lartësohen, marrin flakë: "Unë kam lindur në Melo, qytet i shtëpive koloniale..." Epo, kjo nuk është shumë..., "shtëpi koloniale", pak më ndryshe "shtëpi të stilit kolonial"... "Unë kam lindur në Melo, një qytet i shtëpive koloniale, në mes të fushave të pafundme, plot panik", dhe tani zmadhohet, "në mes të fushave të pafundme, plot panik dhe pranë Brazilit". Shikoni si vjen duke u rritur vargu, ë? Si vjen duke u zgjeruar!

**Llosa: Mbi të gjitha, sepse e**

thoni ju.

**Borges:** Jo, por... "Unë kam lindur në Melo, një qytet me shtëpi koloniale" nuk është asgjë; "në mes të rrafshinës së pafund dhe të frikshme, pranë Brazilit", dhe tashmë shikon një krenari në fund të vargut. Është shumë e bukur. Emilio Oribe.

**Llosa:** Është shumë e bukur. **Borges:** Është një gjë, për të cilën ka vite që dua t'ju pyes. Unë shkruaj romane dhe gjithmonë më lëndon një frazë juaja, shumë e bukur, por shumë fyese për një romancier, një frazë që, pak a shumë, është kështu: "Është prirje varfanjake të kërkosh të shkruash romane, të duash ta zgjerosh në pesëqind faqe diçka që mund të formulohet në një frazë të vetme".

**Borges:** Po, por është një gabim, një gabim, sipas meje. Të sorollatesh kot, apo jo? Ose të jesh i paafët.

**Llosa:** Por keni qenë një lexues i shkëlqyer dhe një përkthyes i mrekullueshëm i romaneve.

**Borges:** Jo, jo. Unë kam lexuar shumë pak romane.

**Llosa:** Megjithatë, romanet shfaqen në veprën tuaj, janë përmendur, madje janë sajuar.

**Borges:** Po, por unë jam tmerruar nga romancieri Uilliam M. Thackeray (Thackeray). Përkundrazi, Dinkes më pëlqen shumë.

**Llosa:** "Vanity Fair" (Panairi i kotësive) ishte shumë i mërzi-shëm për ju.

**Borges:** Romanin "Pendennis", me shumë sforcim, munda ta lexoj, por, "Vanity Fair", jo, nuk munda.

**Llosa:** Josef Konrad (Joseph Conrad), për shembull, është një autor që ju e admironi, nuk ju interesojnë romanet e Konradit?

**Borges:** Po, sigurisht që po, veçse këtu bëj disa përjashtime. Për shembull, rasti i Henri Xhejmsit (Henry James), i cili, le të themi, ishte tregimtar dhe romancier i shkëlqyer, i një kalibri tjetër.

**Llosa:** Por, midis autorëve më të rëndësishëm për ju, a nuk ka ndonjë romancier?

**Borges:** ...

**Llosa:** A do të përmendnit ndonjë romancier midis autorëve që ju i konsideroni më të rëndësishëm, apo ata janë kryesisht poetë dhe eseistë?

**Borges:** Dhe tregimtarë.

**Llosa:** Dhe tregimtarët.

**Borges:** Sepse nuk mendoj që "Një mijë e një net" është një roman, apo jo? Është një antologji e pafund.

**Llosa:** Avantazhi i romanit është se gjithçka mund të jetë roman. Mendoj se është një zhanër kanibal, i cili i gëlltit të gjitha zhanret.

**Borges:** Sa i përket "kanibalit", e

dini origjinën e fjalës?

**Llosa:** Jo, nuk e di, cila është?

**Borges:** Shumë e bukur. Karaibe, nga e cila vjen karibal dhe pastaj kanibal.

**Llosa:** Pra, qenka një fjalë me origjinë latino-amerikane.

**Borges:** Po, por pa "latino". Ata ishin një fis indianësh, karibët, një fjalë indigjene, dhe prej andej erdhi kanibal dhe Kaliban, te Shekspiri.

**Llosa:** Kontribut interesant i Amerikës në fjalorin universal.

**Borges:** Ka shumë të tjera: çokollatë, që ishte xocoatl, besoj, apo jo? Për fat të keq, ka humbur "l", në fund. Po ashtu papa.

**Llosa:** Sipas jush, cili ka qenë kontributi më i mirë i Amerikës në fushën e letërsisë? I gjithë Amerikës: Amerikës hispanike, portugeze... Ndonjë autor, ndonjë libër, ndonjë temë?

**Borges:** Unë do të thosha se gjëja më e mirë është modernizmi, në përgjithësi. Ishte vepër e letërsisë në gjuhën spanjolle, dhe kjo buron nga kjo anë, ana jonë, siç thekson Maks Enrikes Urenja (Max Henríquez Ureña). Unë kam folur me Huan Ramon Himenesin (Juan Ramón Jiménez) dhe ai më ka treguar për emocionin me të cilin kishte marrë një kopje të Maleve të arit (vepër poetike e Leopoldo Lugonesit, 1897), dhe për ndikimin e tij te poetë të mëdhenj në Spanjë. Prandaj, them se vjen nga kjo anë. Dhe çuditërisht, ne këtu jemi shumë më afër Francës – jo gjeografikisht – nga ç'janë spanjollët. Unë, në Spanjë, kisha vënë re se mund të lavdëroje Anglinë, Italinë, Gjermaninë, madje edhe Amerikën e Veriut, por, nëse lavdëroje Francën, atyre nuk u vinte mirë.

**Llosa:** Kudo, nacionalizmi është diçka shumë e vështirë për t'u çrrënjësuar.

**Borges:** Një nga të këqijat e mëdha të kohës sonë.

**Llosa:** Po, Borges, për këtë do të doja të flisja pak, sepse... Mendoj se mund t'ju flas me shumë sinqeritet.

**Borges:** Po, dhe unë, veç kësaj, dua t'ju them se është një e keqe që u përket të djathtëve dhe të majtëve.

**Llosa:** Disa nga deklaratat tuaja politike edhe mund të më habitin, por, kur flisni për çështjen e nacionalizmit, meritoni gjithë admirimin dhe respektin tim. Mendoj se përherë keni folur me kthjelltësi të madhe për këtë temë, ose, më saktë, kundër nacionalizmit.

**Borges:** E megjithatë, unë e kam pësuar prej tij.

**Llosa:** Por tani, me këta të fundit...

**Borges:** Për faktin si flas për brigjet e Buenos Airesit, për faktin se nuk i njoh bejtet patriotike dhe sherrxhinjtë patriotë, pse

nuk i pranoj këto gjëra në letërsinë time. Unë kam shkruar milonga\*... Gjithçka është e denjë për letërsi, pse jo edhe tema autoktone?

**Llosa:** Unë e kam fjalën për nacionalizmin politik.

**Borges:** Ky është një gabim, sepse, nëse dikush do një gjë kundër tjetrit, është diçka që, në të vërtetë, nuk do ta dëshironit. Për shembull, nëse unë dua një gabim, duhet t'i dua të dyja vendet, brenda mundësive të mia.

**Llosa:** Ju keni bërë shumë deklaratat kundër çdo armiqësie të mundshme midis Argjentinës dhe Kilit.

**Borges:** Edhe më shumë duhej. Edhe pse, aktualisht, jam nip dhe stërnip ushtarakësh dhe, më larg, pushtuesish, të cilët nuk më interesojnë fare, unë jam pacifist. Mendoj se çdo luftë është një krim. Madje edhe, kur pranohen si luftëra të drejta, siç ishte, pa dyshim, Lufta e Gjashtë Ditëve\*; nëse pranojmë një luftë të drejtë, qoftë edhe një të vetme, kjo, tashmë, i hap derën çdo lufte dhe kurrë nuk do të mungojë arsyeja për ta justifikuar atë, sidomos kur akuzohen dhe burgosen si tradhtarë ata që mendojnë ndryshe. Unë, dikur, nuk i kisha kuptuar që Bertrand Ruselli, Gandi, Huan B. Alberdi dhe Romen Rolani kishin të drejtë të kundërshtonin luftën; dhe ndoshta tani nevojitet më shumë guxim për të kundërshtuar luftën sesa për ta përkrahur apo për të marrë pjesë në të.

**Llosa:** Për këtë, jam dakord me ju. Mendoj se është shumë e saktë kjo që thoni. Cili është regjimi politik ideal për ju, Borges? Çfarë do të dëshironit për vendin tuaj dhe për Amerikën Latine? Ç'regjim do t'ju dukej më i përshtatshëm për ne?

**Borges:** Unë jam një anarkist i vjetër spencerian dhe besoj se shteti është një e keqe, por për momentin është një e keqe e

nevojshme. Nëse do të isha diktator, do të hiqja dorë nga posti im dhe do të kthehesha te letërsia ime shumë modeste, sepse nuk kam zgjidhje tjetër për të ofruar. Unë jam një person i hutuar, i dekurajuar, si të gjithë bashkatdhetarët e mi.

**Llosa:** Por ju e konsideroni veten një anarkist, në thelb, një njeri që mbron sovranitetin individual kundër Shtetit.

**Borges:** Po. Megjithatë, nuk e di nëse jam i denjë. Gjithsesi, nuk besoj se ky vend është i denjë për demokraci apo anarki. Ndoshta në vendet të tjera mund të bëhet, në Japoni ose në vendet skandinave. Këtu, pa dyshim, zgjedhjet do të ishin të këqija dhe do të sillnin një Frondizi\* tjetër apo të tjerët..., etj.

**Llosa:** Ky skepticizëm sikur bie ndesh me disa prej deklaratave tuaja optimiste që bëni për paqen, pikërisht kundër luftës, së fundmi, kundër torturave dhe të gjitha formave të shtypjes.

**Borges:** Po, e di. Por nuk e di nëse kjo mund të jetë e dobishme. Unë i kam bërë ato deklaratat për arsye etike, por nuk mendoj se janë të dobishme, nuk mendoj se mund t'i ndihmojnë ndokujt. Ato mund të më ndihmojnë të qetësoj ndërgjegjen time, asgjë më shumë. Por, nëse unë do të isha një qeveri, nuk e di se çfarë do të bëja, ne jemi në një rrugë qorre.

**Llosa:** Unë, pothuajse, një çerek shekulli më parë, ju kam bërë një intervistë në Paris dhe një nga gjërat që ju pyeta...

**Borges:** Një çerek shekulli... Prit. Është tejet e trishtuar, nëse do të flasim për një çerek shekulli përpara...

**Llosa:** ...një gjë që ju pyeta ishte se ç'mendonit për politikën, dhe a e dini se si m'u përgjigjët? "Është një nga format e mërzi-së".

**Borges:** Oh, mirë, në rregull.

**Llosa:** Ishte një përgjigje e bukur, por nuk e di, nëse do t'jua përsëritja tani: vazhdoni të mendoni se është një nga format e mërzi-së?

**Borges:** Hëm, do të thosha se fjala mërzi është pak e butë. Gjithsesi, le të themi e neveritshme. Mërzitje është tepër... Është një understatement...

**Borges:** Nuk e di nëse dikush mund të admirojë politikanë, njerëz që janë të përkushtuar për të rënë dakord, për t'u korruptuar, për të buzëqeshur, për t'u fotografuar dhe, më falni, për të qenë popullorë...

**Llosa:** Ç'tip njerëzish admironi ju, Borges? Aventurierët...

**Borges:** Po, i kam admiruar shumë, por tani nuk e di. Më pëlqejnë aventurierët individualë.

**Llosa:** Cilin, për shembull? Ju kujtohet ndonjë aventurier që do të donit të ishit?

**Borges:** Jo, nuk do të doja të isha dikush tjetër.

**Llosa:** Ju jeni i lumtur me fatin e Borgesit.

**Borges:** Jo, nuk jam i lumtur, por e di që me një fat tjetër do të isha dikush tjetër. Dhe, siç thotë Spinoza, "çdo gjë dëshiron vetminë e qenies së vet". Unë insistoj të jem Borges, nuk e di pse.

**Llosa:** Mbaj mend një nga frazat tuaja: "Kam lexuar shumë gjëra dhe kam jetuar pak", e cila nga njëra anë është shumë e bukur dhe nga ana tjetër duket nostalgjike...

**Borges:** Shumë e trishtuar.

**Llosa:** Duket se po qaheni.

**Borges:** E kam shkruar kur isha tridhjetë vjeç dhe nuk e kuptoja që të lexuarit është gjithashtu një mënyrë jetese.

**Llosa:** Por, a nuk keni ndonjë peng për gjëra që nuk i keni bërë, ngaqë i jeni përkushtuar për kaq shumë kohë jetës thjesht intelektuale?

**Borges:** Besoj se jo. Mendoj se me kalimin e kohës njeriu, në thelb, i jeton të gjitha gjërat dhe,



më e rëndësishme, nuk janë përvojat, por ajo që njeriu bën me to.

**Llosa: Mendoj se kjo ju ka çliruar shumë nga gjërat materiale. Kushdo e kupton këtë, kur vjen në shtëpinë tuaj. Në të vërtetë, ju jetoni si një murg, shtëpia juaj është tepër e thjeshtë, dhoma juaj e gjumit duket si qeli e një murgu trapens, në të vërtetë keni një përkorje të jashtëzakonshme.**

**Borges:** Luksi më duket një vulgaritet.

**Llosa: Ç'kuptim kanë paratë për ju, në jetë, Borges?**

**Borges:** Mundësi për të siguruar libra dhe udhëtime dhe për t'i zgjeruar e për t'i zhvilluar ato.

**Llosa: Por, nuk ju kanë interesuar kurrë paratë? Nuk keni punuar kurrë për të fituar para?**

**Borges:** Epo, edhe nëse e kam bërë, duket se nuk ia kam arritur dot. Sigurisht që mirëqenia është më e mirë se varfëria, veçanërisht në një vend të varfër, ku, tërë kohën, je i detyruar të mendosh për paratë. Një person i pasur mund të mendojë për diçka tjetër. Unë kurrë nuk kam qenë i pasur. Prindërit e mi po, kemi pasur prona dhe i kemi humbur, na i kanë konfiskuar, por, gjithsesi, nuk mendoj se ka shumë rëndësi kjo.

**Llosa: Ju e dini që një pjesë e mirë e vendeve të kësaj toke sot jetojnë në varësi të parave, mirëqenia materiale është nxitja e tyre.**

**Borges:** Është e natyrshme të jetë ashtu, sidomos kur ka një varfëri të tillë. Për çfarë tjetër mund të mendojë një lypës, veçse për paratë dhe ushqimin. Nëse ju jeni shumë i varfër, duhet të mendoni për para. Një i pasur mund të mendojë për diçka tjetër, por një i varfër, jo. Ashtu sikurse edhe një i sëmurë duhet të mendojë vetëm për shëndetin. Secili mendon për atë që i mungon, jo për atë që ka. Kur unë e kisha shikimin, nuk mendoja se ky ishte një privilegj, ndërsa sot do të jepja gjithçka për të më riardhur shikimi dhe nuk do të dilja nga kjo shtëpi.

**Llosa: Borges, më ka befasuar shumë shtëpia modeste në të cilën jetoni, veçanërisht dhoma juaj e gjumit aq e thjeshtë. Një nga objektet e pakta që shikon në dhomën tuaj të gjumit është medalja e Urdhrit të Diellit dhënë nga qeveria peruane.**

**Borges:** Është medalja që iu dha familjes sonë, pas katër brezave.

**Llosa: Dhe si ka ndodhur kjo, Borges?**

**Borges:** Atë medalje e ka marrë stërgjyshi im, kolonel Suares, i cili drejtoi një sulm të kalorësisë peruane në Hunin. Ai e fitoi atë Urdhër dhe mori gradën e kapiten-kolonelit nga Bolivari\*. Pastaj, gjatë Luftës Civile, atë Urdhër e humbi. Edhe pse familja ime ishte unitare\*, së largu, unë jam i lidhur me De

Rosas\* – ne, të gjithë jemi të afërm në këtë vend pothuajse të pabanuar. Pas katër brezave kjo medalje na u kthye, tashmë për motive letrare, për këtë, unë shkova me time ëmë në Lima, e cila qau, sepse i kujtohej që këtë medalje e shihte në portretet e gjyshit tim, ndërsa tani e kishte në duar dhe ishte për djalin e saj. Ishte shumë, shumë e emocionuar.

**Llosa: Me fjalë të tjera, marrëdhënia juaj me Perunë shtrihet në shumë breza.**

**Borges:** Po, në katër breza. Madje, është më herët, do t'ju them, unë isha... Ah, jo, jo, prit... Po. Unë kam qenë në Kusko dhe kam parë një shtëpi me një emblemë në formën e kokës së dhisë, dhe aty kishte qenë Heronimo Luis de Cabrera\* (Jerónimo Luis de Cabrera), katërqind vjet më parë, i cili ka themeluar një qytet të quajtur Ika, që nuk e di se ku është, dhe qytetin Kordova, në Argjentinë. Dua të them, është një marrëdhënie e vjetër.

**Llosa: Kështu që ju, në njëfarë mënyre, jeni edhe peruan.**

**Borges:** Po. Sigurisht që po.

**Llosa: Çfarë ideje kishit për Perunë, përpara se të shkonit në Lima?**

**Borges:** Një ide shumë të paqartë që mendoj se ishte mbështetur kryesisht te historiani Uliam Preskot (William Prescott).

**Llosa: Te "Historia e pushtimit të Perusë" e Preskotit. Kur e keni lexuar atë histori?**

**Borges:** Ndoshta, duhet të kem qenë shtatë ose tetë vjeç. Libri i parë i historisë që kam lexuar në jetën time. Më vonë, kam lexuar "Historinë e Republikës së Argjentinës" të Visente Fidel Lopesit (Vicente Fidel López), dhe më pas historinë e romakëve dhe atë të grekëve. Por, libri i parë që kam lexuar, "throughout", domethënë, nga fillimi në fund, ka qenë ai.

**Llosa: Dhe çfarë ideje kishit për Perunë, atë të një vendi ndoshta mitik?**

**Borges:** Po. Pak mitik. Dhe, më pas, unë u bëra shumë mik me një shkrimtar, pa dyshim i harruar prej jush, peruani Alberto Hidalgo, nga Arekipa.

**Llosa: Që ka jetuar një kohë të gjatë në Argjentinë, apo jo?**

**Borges:** Po, dhe ai më zbuloi një poet nga i cili unë mësova shumë poezi përmendsh.

**Llosa: Cili poet, Borges?**

**Borges:** Eguren.

**Llosa: Ose Maria Eguren (José María Eguren).**

**Borges:** Po. Ai. Libri quhej Vajza me llambën blu, apo jo?

**Llosa: Është një poemë, një nga poemat më të njohura të Egurenit.**

**Borges:** Po. Ishte dhe një poemë



tjetër... Unë kam një imazh të paqartë për një anije dhe një kapiten të vdekur që drejton anijen. Nuk i mbaj mend vargjet.

**Llosa: Është një poet simbolist me çiltërsi dhe delikatesë të madhe.**

**Borges:** Një delikatesë e madhe. Nuk e di nëse edhe çiltërsi. Unë mendoj se ai ishte qëllimisht i çiltër.

**Llosa: Them i çiltër jo në kuptimin pezhorativ, jo naiv.**

**Borges:** Jo, jo. Natyrisht, çiltërsia është një meritë.

**Llosa: Ai nuk doli kurrë nga Peruja dhe besoj se edhe nga Lima, kurrë. Dhe, për habi, një pjesë të mirë të veprës së tij e shkroi për një botë nordike, për zana skandinave. Tema veçanërisht ekzotike për të.**

**Borges:** Sepse nostalgjia është shumë e rëndësishme.

**Llosa: Ndoshta kjo krijon njëfarë afërsie midis jush, midis Egurenit dhe jush.**

**Borges:** Po. Është e vërtetë që unë jam duke menduar për vende që nuk i njoh ose që i kam njohur shumë më vonë. Do të dëshiroja shumë të njihja Kinën ose Indinë..., megjithëse tashmë, në fushën e letërsisë, i njoh mirë.

**Llosa: Cili vend do t'ju emociononte më shumë, po ta njihnit, Borges?**

**Borges:** Nuk e di, do të thosha Japonia, Anglia dhe...

**Llosa: Islanda, për shembull?**

**Borges:** Islanda, pa dyshim, sepse unë jam duke studiuar gjuhën nordike, e cila është gjuha mëmë e suedishtes, norvegjishtes, danishtes,

e gjithashtu, pjesërisht, e anglishtes.

**Llosa: Është një gjuhë që ka pushuar së foluri, sa shekuj më parë?**

**Borges:** Jo, jo, aktualisht, flitet në Islandë. Kam botime të klasikëve, vepra të shekullit XIII, dhe këto botime, që m'i kanë dhuruar ose i kam blerë në Rejkjavik, nuk kanë fjalor, as prolog dhe as shënime.

**Llosa: Me fjalë të tjera, është një gjuhë që nuk ka evoluar, që vazhdon të jetë e njëjtë, gjatë tetë shekujve.**

**Borges:** Unë dyshoj se shqiptimi ka ndryshuar. Ata mund të lexojnë klasikët e tyre, ashtu si një anglez mund të lexojë, për shembull, William Dunbar, Geoffrey Chaucer-in, ose sikur të mund të lexonim, nuk e di, Këngët e Sidit spanjoll apo La chanson de Roland francez.

**Llosa: Ose grekët e Homerit.**

**Borges:** Po, pikërisht. Ata mund t'i lexojnë klasikët e tyre në botime pa shënime, pa fjalorë, pa dyshim, duke i shqiptuar ato në një mënyrë tjetër. Por, për shembull, shqiptimi në anglisht gjithashtu ka ndryshuar shumë. Ne themi To be or not to be dhe duket se Shekspiri, në shekullin e XVII i thotë ende, duke i ruajtur zanoret e hapura saksonë: "Tou be or nat Tou be be." Kjo është shumë më kumbuese, krejtësisht e ndryshme, dhe pothuajse komike, tani.

**Llosa: Borges, ky kuriozitet ose, më shumë se kuriozitet, kjo magjepsje juaja ndaj letërsisë ekzotike...**

**Borges:** Nuk e di nëse është ekzotike...

**Llosa: I referohem interesit tuaj**

për letërsinë nordike ose anglosaksonë.

**Borges:** Epo, anglo-saksonia është letërsia e lashtë angleze.

**Llosa: ...ju besoni se ka të bëjë me...**

**Borges:** Me nostalgjinë?

**Llosa: Me Argjentinën, me faktin se Argjentina është një vend krejtësisht modern, pothuaj, pa të kaluar.**

**Borges:** Po. Ashtu besoj, dhe se ndoshta një nga pasuritë tona është nostalgjia. Mbi të gjitha, nostalgjia për Evropën, që një evropian nuk mund ta ndiejë, sepse një evropian nuk ndihet evropian, por, le të themi, anglez, francez, gjerman, spanjoll, italian, rus... /Gazeta "ExLibris"/

\* *Graciela Noemí Zabala (1941) – e njohur si Graciela Borges, artiste argjentinase, qysh kurshkrimtari Jorge Lis Borges i fali mbiemrin e tij, sepse i ati i saj ia ndaloi përdorimin e mbiemrit të tij.*

\* *Milonga – tekste këngësh popullore.*

\* *Lufta e Gjashtë Ditëve – lufta midis Izraelit dhe koalicionit arab (1967)*

\* *Arturo Frondizi – president i Argjentinës (1958 – 1962), vendosi një regjim diktatorial.*

\* *Simon Bolívar (1783 – 1830) – figura më e madhe në historinë e Amerikës Latine, luftëtar dhe çlirimtari i saj prej kolonizatorëve spanjollë.*

\* *Unitar – ithtar i Partisë Unitare, themeluar në shek. XIX.*

\* *Juan Manuel de Rosas (1793 – 1877) – ushtarak dhe politikan argjentin.*


\* *Jerónimo Luis de Cabrera (1528 – 1574) – ushtarak, eksplorator dhe kolonizator spanjoll.*

## Enca vazhdon publikimin e imazheve atraktive të shkëputura nga klipi i ri



**K**ëngëtarja e njohur shqiptare Enca Haxhia i ka provokuar ndjekësit në "Instagram". Teksa është në përgatitje të projektit të ri muzikor, ajo po shkëput imazhe

të realizuara gjatë xhirimeve. Ajo dhe Don Xhoni kanë bashkuar idetë për projektin e ri muzikor. Data e publikimit të këndës ende nuk është bërë me dije.




## Një tjetër sukses për Dua Lipën

**D**ua Lipa është duke thyer rekorde e shënuar succese të shumta me anë të albumit të saj më të ri 'Future Nostalgia'. Kënga 'Break my heart', e cila është pjesë e këtij albumi, ka arritur të zë vendin e parë në 'US Top 40 Radio'

dhe për këtë këngëtarja është tejet krenare. Vetë Dua ishte ajo që e bëri të ditur këtë sukses, duke publikuar disa imazhe nga prapaskenat e klipit të këtij projekti dhe si mbishkrim la "Break my heart është numër 1 në US Top 40 Radio".

## Doja Cat: U infektova me Covid-19



**V**irusi Covid-19 e ka pushtuar gjithë botën, shkruajnë mediat e huaja. Ka pasur edhe emra të njohur të ekranit që kanë treguar publikisht se ishin të prekur me koronavirus. Edhe Doja Cat ka zbuluar, po ashtu, se ka qenë e infektuar me Covid-19. 24-vjeçarja, emri i vërtetë i së cilës është Amala Ratna Zandile Dlamini, një gjë të

tillë e ka konfirmuar në një intervistë në Capital XTRA. "Unë u infektova me Covid. Sinqerisht, nuk e di se si ndodhi, thjesht u infektova" është shprehur ajo. Krijuesja e hitit "Say So", ndër të tjera, shtoi se pasi e vërtetoi, nuk kishte frikë. "Jam mirë tani. Pata simptoma për katër ditë, por tani jam shumë mirë", shtoi ajo.

## Blero paralajmëron projektin e ri muzikor



**K**ëngëtari Blero që nga fillimet e para të karrierës ka qenë i komentuar në media. Succesi në muzikë, e më pas jeta private. Ndarja me Teuta Krasniqin, lidhja e martesë me Afrona Dikën ishin vetëm disa nga arsyet. Së fundmi është komentuar për ribashkimin me Afronën pasi i kishte 'ndarë' pan-

demia pasi nuk e kishin mundësinë të udhëtonin për t'u takuar. Dyshja i kanë kaluar pushimet në bregdetin shqiptar e tani Blero i është kthyer punës dhe po sjell projektin më të ri muzikor. "Sa t'kom dasht", mban titullin ky projekt për të cilin këngëtari nuk ka dhënë ndonjë detaj shtesë apo datën e saktë të publikimit.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

'BUJQËSIA'

TEL: 045/82 82 82

# Gjilani e çon Flamurtarin në Ligën e Parë



Drita është shpallur kampione e Kosovës në futboll, kurse Gjilani ka përfunduar në pozitën e dytë dhe dy skuadrat gjilanasë do ta prezantojnë Kosovën në garat ndërkombëtare. Flamurtari është skuadra e katërt që i bashkohet Vushtrrisë, Ferizajt dhe Dukagjinit në Ligën e Parë

të Ligës së Kampionëve, kurse Gjilani merr pjesë në garat e Ligës së Evropës. Nga Superliga, përveç Flamurtarit, largohen edhe Vushtrria, Ferizaj dhe Dukagjini i Klinës.

## IPKO SUPERLIGA

Drenica - Dukagjini	1-0
Vushtrria - Llapi	5-3
Ferizaj - Feronikeli	2-4
Trepça '89 - Prishtina	2-1
Flamurtari - Gjilani	0-1
Ballkani - Drita	2-1

### Tabela

1. Drita	33	68 pikë
2. Gjilani	33	68
3. Ballkani	33	67
4. Prishtina	33	62
5. Feronikeli	33	47
6. Llapi	33	45
7. Trepça '89	33	44
8. Drenica	33	44
9. Flamurtari	33	43
10. Ferizaj	33	29
11. Vushtrria	33	21
12. Dukagjini	33	19

pjesëmarrjen në Evropë nëpërmjet garës së Kupës, ku në finale është me Prishtinën.

Për Ballkanin shënues ishin Berisha dhe Daku, kurse për Dritën golin e vetëm e shënoi Xhevdet Shabani. Trepça '89 e siguroi mbetjen në Superligë pas fitores ndaj Prishtinës me përmbysje (2-1). Avdyli dhe Manaj shënuan për 89-shin, kurse për kryeqytetasit shënoi Zyba. Drenica e mposhti Dukagjinin me rezultat 1-0, derisa Vushtrria e mposhti Llapin (5-3).

Ish-skuadra kampione e Kosovës, Feronikeli, e mbylli kampionatin me fitore ndaj Ferizajt (2-4). Kampione e Superligës në xhiron e kaluar është shpallur Drita, skuadër e cila do të marrë pjesë në garat parakualifikuese

## SHKURT

### KB Ylli vazhdon bashkëpunimin me Zekiçin

KB Ylli është skuadra e vetme në Superligën e Kosovës në basketboll që ka lëvizur në organizim dhe forcim të skuadrës. Klubi nga Suhareka në njoftimin e fundit ka bërë me dije se ka arritur marrëveshje me yllin e tyre nga Mitrovica, Samir Zekiçi. "Ju kemi thënë se nuk do prezantim. Samir Zekiçi është me ne", ka shkruar KB Ylli.

### Futbollisti i Wolfsburgut infektohet me Covid-19

Koronavirusi vazhdon të jetë i pranishëm në futboll. Rasti më i fundit vjen nga Gjermania, ku klubi i Wolfsburgut ka konfirmuar një rast pozitiv. Mbrojtësi i djathtë, Kevin Mbabu, ka dalë pozitiv me Covid-19. Zvicëri është izoluar menjëherë dhe në ditët e ardhshme pritet ta bëjë edhe testin e dytë.

### Namani vazhdon edhe për dy vjet kontratën me Dritën

Kampionia e re e IPKO Superligës së Kosovës në futboll, Drita, e ka vazhduar marrëveshjen e bashkëpunimit me mesfushorin Hamdi Namani. Ky i fundit, Namani, një vit më parë iu bashkua klubit gjilanas nga skuadra e Llapit, kurse do të jetë pjesë e kampionëve të Kosovës edhe për dy vjet të tjera. "Kemi arritur marrëveshje për vazhdimin e kontratës edhe për dy vjetet e ardhshëm me Hamdi Namanin-Lumi. Lumi një vit më parë erdhi nga ekipi i Llapit, ku ishte edhe kapiten dhe u ambientua mjaft mirë me ekipin tonë, ku arriti të shpallet kampion i Kosovës për herë të parë në karrierën e tij dhe ishte dëshirë e dyanshme për të vazhduar së bashku. Lumi do të jetë bardh e kaltër deri në qershor të 2022-s. Paçim fat në garat ndërkombëtare LUM", thuhet në njoftimin e Dritës.

### Quartararo fiton Çmimin e Madh të Andaluzisë

Fabio Quartararo fiton garën e dytë radhazi në Botërorin e Moto Gp duke u shkëputur i vetëm në krye të klasifikimit të përgjithshëm. Francezi i talentuar dominoi Çmimin e Madh të Andaluzisë teksa pasi u nis nga pole-position regjistroi edhe xhiron më të shpejtë në garë, ndërsa e kryesoi nga fillimi deri në fund garën e zhvilluar në pistën e Jerezit de la Frontera. Në podium bashkë me pilotin e Petronas Yamaha SRT u ngjiten edhe dy pilotët e Yamahas zyrtare, Maverick Vinales dhe Valentino Rossi që bëri një garë shumë të mirë duke iu gëzuar në fund vendit të tretë. Vendi i 4-t për japonezin Taakaki Nagami që në mungesë të Marc Marquez, mbajti lart flamurin e Hondas, i ndjekur nga Joan Mir dhe Andrea Dovizioso. Vetëm vendi i tetë për vëllanë e Marc Marquez, Alex Marquez që, gjithashtu, garon me Repsol Hondan.

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 26 KORRIK - Skuadra e Gjilanit e ka fituar ndeshjen ndaj Flamurtarit me rezultat 0-1 dhe në këtë mënyrë e ka siguruar pjesëmarrjen në Ligën e Evropës e në anën tjetër e ka çuar Flamurtarin në Ligën e Parë. Rezak ka shënuar golin e vetëm në ndeshje në minutën e 73-të, kurse Stullqaku në minutat shtesë është ndëshkuar me karton të kuq. Derbin e kësaj xhiroje e fitoi Ballkani ndaj Dritës (2-1), por këto tri pikë ishin të pamjaftueshme për klubin e drejtuar nga Ismet Munishi për ta siguruar pjesëmarrjen në garat ndërkombëtare. Megjithatë, ky klub e ka një mundësi të tillë të sigurojë



## Arteta: Mezi arrita ta bind Xhakën për të qëndruar në Arsenal

LONDËR, 26 KORRIK - Trajneri i Arsenalit, Mikel Arteta, ka thënë se do të llogarisë në shërbimet e mesfushorit shqiptar Granit Xhaka për sezonin e ardhshëm. Shumë tifozë dhe ekspertë besuan se ylli shqiptar nuk do të luante më kurrë për Arsenalin, pasi iu hoq shiriti i kapitenit nga

menaxheri i atëhershëm Unai Emery nëntorin e kaluar. "Për një lojtar futbolli kur jeni në fushë dhe mendoni se i keni tifozët që ju mbështesin dhe ndieni dashurinë e tyre, kjo ju jep një sasi të jashtëzakonshme të energjisë. Shpresojmë që ai mund të shijojë atë kur tifozët të rikthehen në

stadiumin tonë", ka thënë Arteta. "Njerëzit e dinë më mirë se unë se çfarë ndodhi dhe sa ndikoi në të gjitha palët kur ndodhi ajo çështje. Kur arrita këtu kam pasur një mendim shumë të lartë për të dhe e njihja vërtet mirë. Më duhej ta bindja që ai kishte një të ardhme, ai kishte një

vend këtu dhe ai mund ta shijonte karrierën e tij dhe familja e tij mund të ishte e lumtur këtu. Ai është një lojtar që jep gjithmonë 100 për qind. Ai ka punuar me të vërtetë shumë dhe ai ka fituar përsëri besimin e të gjithëve. Mendoj se ai ka filluar ta shijojë atë përsëri dhe, normalisht, kur i



keni këto dy aspekte së bashku, kjo është kur lojtarët performojnë në nivelin më të lartë", ka deklaruar Arteta.

## Hysaj: Barcelonë, gati edhe për ju

NAPOLI, 26 KORRIK - Elseid Hysaj shënoi një ditë më parë dhe ky është lajm. I pari gol në Serinë A, me një lojtar që nën drejtimin e Gennaro Gattuso, ka gjetur hapësirë dhe po e ndihmon skuadrën edhe në krahun e majtë. E ardhmja e tij ka qenë gjithmonë një temë diskutimi dhe mbetet ende, kur dihet se verën e ardhshme i përfundon kontrata. Gjithsesi është koha ta shijojë golin dhe Hysaj pas ndeshjes kundër Sassuolos ka deklaruar: "Jam shumë i lumtur për këtë gol të realizuar, edhe pse më vjen keq që po luajmë pa tifozë. Gëzohem prej golit dhe shpresoj të shënoj të tjerë në të ardhmen. Ky gol shkon për bashkëshorten dhe familjen time".



Napoli pësoi katër herë, por më ndërhyri dhe Sassuolo nuk iu gëzua dot një goli të vetëm. Takimi i radhës është kundër Barcelonës dhe shkalla e vështirësisë do të jetë më e

madhe në atë takim. "Ishin katër gola të pësuar, por fatmirësisht ka VAR. Gjithsesi ne duhet të jemi të kujdesshëm. Sassuolo është një skuadër në formë dhe që luan një futboll të bukur, edhe pse kundër Barcelonës ndryshon cilësia e futbollistëve. Pavarësisht gjithçkaje, ne do të jemi gati për ndeshjen e Champions League", shtoi Hysaj, një nga më të

vlerësuarit për ndeshjen kundër Sassuolo. Në fund dy fjalë edhe për të ardhmen e tij, shumë të diskutuar: "Jam mirë në Napoli, në fushë dhe jashtë saj. Nuk di asgjë në lidhje me të ardhmen. Do të flasim me klubin në fund të sezonit, pasi për momentin ka ndeshje të rëndësishme përpara dhe duhet të fokusohemi aty".

## City-Real do të luhet në një fushë neutrale

Koronavirusi rikthehet si kërcënim për turneun më prestigjioz të futbollit të klubeve, në veçanti për sfidën mes Manchester Cityt dhe Realit të Madridit, kthim i 1/8 të finaleve të Champions i programuar më 7 gusht. Për shkak të shtimit të numrit të të infektuarve në Spanjë, autoritetet britanike kanë aplikuar një karantinë të detyrueshme prej 14 ditësh për të gjithë ata që vijnë nga vendi iberik. Por ky vendim i qeverisë Xhonson shqetëson realin e Madridit që kështu pamundësohet për ta luajtur ndeshjen në "Etihad Stadium", pasi skuadra nuk mund të qëndrojë dy javë e izoluar. Kjo situatë ka shtyrë UEFA-n të mendojë zgjidhje alternative dhe të gjejë stadione neutrale. Në ndeshjen e parë Manchester



City është imponuar 2-1 ndaj galaktikëve dhe është favorit për të qenë në fazën "Final 8" në Lisbonë. Por kthehet në një rebus, situata rreth stadiumit të përplasjes së pretendentëve. UEFA mendon Porto ose

Gimaraesh si stadiumet alternative në rast se qeveria britanike nuk do t'i lehtësojë masat të paktën për ekipet e futbollit. Nëse nuk luhet në "Etihad Stadium", sfida e Sitizens do të spostohet jashtë kufijve.

### SHKURT

#### Brenda 15 ditësh vendoset e ardhmja e Kumbullës

Gara për Marash Kumbullën mbetet ende shumë e fortë. Mbrojtësi shqiptar nuk e di ende të ardhmen e tij me Interin dhe Lazio që duan ta rëmbejnë për edicionin e ri. Presidenti i klubit, Maurizio Setti, foli për Radio DeeJay në lidhje me të ardhmen e mbrojtësit shqiptar. "Nuk e di nëse Kumbulla do të transferohet tek Interi apo te Lazio. Të shohim, do të jetë një garë e bukur deri në fund. Kemi marrë disa oferta për lojtarin, rëndësi ka që në fund të kënaqemi të gjithë: Marashi dhe klubi ynë. Duhet të prisni edhe pak, do të vendosim përfundimisht në lidhje me lojtarin në 10-15 ditët e ardhshme", ka deklaruar numri një i klubit në lidhje me të ardhmen e Marash Kumbullës.

#### Presidenti i Barcelonës: Na intereson Martinezi, Messi nuk largohet

Presidenti i Barcelonës, Jozef Maria Bartomeu, ka pranuar interesimin për Lautaro Martinezin, por mohon fjalët për një kalim të Lionel Messit tek Interi. Katalanasit e shohin sulmuesin argjentinas të zikaltërve si zëvendësuesin ideal të Luis Suarezit, por Bartomeu tregon se për momentin nuk ka zhvillime të reja. Në një intervistë për "El Mundo Deportivo", presidenti i Barcelonës u shpreh: "Ne kemi folur me Interin për Lautao, por për momentin nuk ka të reja. Fokusi ynë tani është Liga e Kampioneve që do të rifillojë së shpejti". Më pas Bartomeu foli edhe për Messin, me argjentinasin që është përfolur kohët e fundit për një kalim tek Interi, por Bartomeu shprehet i sigurt që Messi do ta përfundojë karrierën te Barcelona. "Messi e ka thënë disa herë që do ta mbyllë karrierën këtu dhe unë nuk kam dyshime për rinovimin e kontratës së tij. Kam një marrëdhënie shumë të ngushtë me Messin, siç bëj me të gjithë kapitenët", ka shtuar Bartomeu.

#### Capello: Reali ka thyer monopolin e Barçës

Ish-trajneri i Real Madridit, Fabio Capello, po shijon edhe më shumë pushimet e tij në Marbella tashmë me Realin kampion. Italiani drejtoi 'Mbretërit' në vitin 1997 dhe 2007, por tani ata i sheh vetëm si një tifoz. Duke folur për 'Marca', Capello ka thënë se ky titull i Real Madridit ka thyer monopolin e Barcelonës. "Titulli ishte i merituar. Ata luajnë futbollin më të mirë në ligë, shënuan gola dhe nuk pësuan", ka thënë Capello. "Madridi i dha fund monopolit të Barcelonës dhe shfrytëzuan avantazhin, por duhet të jemi të qartë: Madridi fitoi titullin me meritat e veta, jo për gabimet e të tjerëve", ka shtuar Capello.

#### Unitedi në garë për Immobilen

Ciro Immobile mund të largohet nga Lazio, pas përfundimit të këtij sezoni. Forma e mirë që ka kaluar sulmuesi italian ka bërë që shumë skuadra të shprehin interesim për të. Së fundi, në garë për Immobilen ka hyrë edhe Manchester United. Madje klubi anglez është i gatshëm të dërgojë një ofertë në drejtim të Lazios për sulmuesin. Për Immobilen, interesim të vazhdueshëm ka shprehur edhe Napoli. 30-vjeçari ka kontratë me Lazio deri në vitin 2023. Këtë sezon sulmuesi italian ka shkëlqyer duke shënuar 34 gola dhe shtatë asistime në të gjitha garat.

## Mbi 10 000 të infektuar me Covid-19 në Maqedoninë e Veriut

SHKUP, 26 KORRIK - Maqedonia e Veriut ka regjistruar mbi 10 000 të infektuar me koronavirusin e ri, që shkakton sëmundjen Covid-19, që nga paraqitja e rastit të parë më 27 shkurt të këtij viti. Sipas raportit të Ministrisë së

Shëndetësisë, të dielën janë regjistruar 152 raste të reja me Covid-19 duke e çuar numrin e të infektuarve në 10 086.

Viktima të reja nuk janë regjistruar, kështu që numri i të vdekurve mbetet 460.

Sa iu përket të infektuarve, numri më i madh i tyre është në Shkup me 39 raste dhe Kumanova me 20, ndërsa numër më të vogël ka në 19 qytete të tjera. Nga numri i përgjithshëm i të infektuarve, raste aktive janë 4 199.

Të dielën janë regjistruar edhe 70 persona të shëruar me çka numri i përgjithshëm i tyre ka arritur në 5 427. Të dhënat i referohen testimi të 1 077 mostrave. Në Maqedoninë e Veriut deri tani janë realizuar 95 169 teste.



## ShBA-ja, sfidat e votimit me postë

Nju Jork, 26 korrik - Kur është fjala te zgjedhjet, pjesa më e madhe e amerikanëve votojnë duke u paraqitur në qendra votimi në lagjet e tyre. Ka gjasa që votimet e nëntorit të zhvillohen shumë ndryshe. Miliona veta pritet të hedhin votën përmes postës këtë radhë si rezultat i pandemisë.

Zyrtarët zgjedhorë po përgatiten për zgjedhjet e nëntorit, kur miliona veta do ta zgjedhin presidentin e ardhshëm të vendit. Këtë radhë pandemia ka sjellë sfida madhore në procesin zgjedhor. Shtete të ndryshme po



zgjerojnë votën me postë si përgjigje. "Nëse parashikojmë një pjesëmarrje në votimet me postë në masën 65-75 për qind

të amerikanëve të regjistruar për të votuar në zgjedhjet e 2020-s, kjo nënkupton 90-105 milionë vota me postë. Ky është

volum shumë i madh poste", ka thënë analisti Eddie Perez.

Votimet shoqërohen me masa të shumta planifikimi dhe sigurie, duke filluar me regjistrimin e atyre që duan të votojnë me postë. "Nga njëherë dëgjon njerëz që e përshkruajnë procesin sikur po dërgohen pa kriter fletëvotime pa asnjë kontroll. Nuk është ashtu", thotë Perezi.

Votuesit marrin fletëvotime specifike për distriktin e tyre zgjedhor, me markën digjitale që lidhet me personin që voton. Pas votimit, personi e hedh votën në kutinë postare

ose e çon në qendrën e grumbullimit. Sistemi më pas skanon markën për ta krahasuar firmën në fletëvotim me firmën e regjistruar në sistem. Më pas regjistrohet vota. Nëse fletëvotimi ka probleme, për shembull nuk ka firmë të rregullt, ai dërgohet për analizë pranë një komisioni. Votuesit mund ta ndjekin përparimin e procesit, ashtu siç ndjekin në kompjuter apo celular itinerarin e një pakoje që kanë dërguar. Procesi është anonim. Zarfë hapet, nxirret fletëvotimi për t'u numëruar.

## Stuhia Hanna godet jugun e Teksasit

HJUSTON, 26 KORRIK - Autoritetet në Shtetet e Bashkuara kanë paralajmëruar për rrezikun nga stuhia Hanna që ka arritur në jug të Teksasit, ku pritet të ketë erëra të forta dhe reshje të mëdha të shiut. Guvernatori Greg Abbot ka deklaruar gjendje emergjente për 32 vende dhe ka theksuar se përhapja e koronavirusit do ta komplikojë punën e shërbimeve emergjente. Stuhia Hanna ka arritur të shtunën në

Ishullin Padre dhe tani është duke kaluar në ishujt Christi dhe Brownsville.

Erërat e forta deri në 145 kilometra në orë kanë shkaktuar dëme në prona private. "Çdo përballje me stuhi është një sfidë mjaft e madhe. Kjo sfidë është më e komplikuar për shkak që ajo po kalon në zonat më të prekura me Covid-19", tha guvernatori Abbot.

Ndërkohë, stuhia Douglas është duke u afruar drejt Pacifikut,

derisa autoritetet kanë paralajmëruar rrezikun nga vërshimet e mëdha.

Presidenti i Shteteve të Bashkuara ka shkruar në "Twitter" se administrata e tij është duke monitoruar situatën në të dyja shtetet. Teksasi është duke u përballur me përhapje mjaft të madhe të koronavirusit. Më shumë se 380 000 të infektuar janë konfirmuar dhe rreth 5 000 viktima.



## Vazhdojnë protestat masive anti-qeveritare në Rusi

MOSKË, 26 KORRIK - Mijëra protestues u mblodhën të shtunën në rrugët e qytetit lindor Khabarovsk të Rusisë, në fundjavën e tretë me radhë, për ta shfaqur pakënaqësinë ndaj largimit nga puna të guvernatorit Sergei Furgal. Protestat po shihen si sfidë në rritje ndaj presidentit rus Vladimir Putin, pasi roli i tij në



largimin e guvernatorit shkaktoi një krizë rajonale.

Shumë nga protestuesit kanë kërkuar dorëheqjen e Putinit.

Disa e kanë quajtur të turpshëm emërimin e zëvendësuesit të guvernatorit nga ana e Putinit.

Autoritetet njoftuan se rreth 6 500 persona morën pjesë në protestë. Mediat lokale thanë se pjesëmarrës ishin 20 000 persona. Por, protestuesit dhe disa gazetarë të pavarur thanë se në protestë kanë marrë

pjesë më shumë se 50 000 persona, duke e bërë këtë protestën më të madhe anti-qeveritare në vend.

Më 9 korrik Sergei Furgal u arrestua para kamerave dhe aktualisht ndodhet në paraburgim në Moskë. Politikani akuzohet se para 15 vjetësh ka qenë i përfshirë në një seri vrasjesh. Ai vetë i hedh

poshtë të gjitha akuzat. Përkrahësit e Furgalit dyshojnë për një largim nga detyra me motive politike. Ndryshe, paralajmërimet e autoriteteve për rrezikun nga koronavirusi nuk i kanë ndaluar protestat masive në Rusi, derisa Kremlinin po tenton ta rimëkëmbë ekonominë.

## Polonia do ta braktisë Traktatin mbi dhunën ndaj grave

Varshavë, 26 korrik - Polonia do të ndërmarrë hapa këtë javë për t'u tërhequr nga një traktat evropian mbi dhunën ndaj grave, që kabineti i krahut të djathtë thotë se shkel të drejtat e prindërve duke u kërkuar shkollave t'u mësojnë fëmijëve për gjininë.

Ministri i Drejtësisë në Poloni, Zbigniew Ziobro, ka thënë në një konferencë për media se ministria që drejton do t'i paraqesë një kërkesë Ministrisë së Punës dhe Familjes të hënën për ta filluar procesin e tërheqjes nga traktati, i njohur si Konventa e Stambollit. "Ai

përmban elemente të një natyre ideologjike, të cilat ne i konsiderojmë të dëmshme", ka pohuar Ziobro.

Partia në pushtet Drejtësi dhe Ligj (PiS) e Polonisë dhe partnerët e saj të koalicionit pozicionohen ngushtë me Kishën Katolike dhe promovojnë një

agjendë konservatore sociale. Qëndrimet e ashpra ndaj të drejtave të homoseksualëve ishte një nga çështjet kryesore të promovuara nga presidenti Andrej Duda gjatë një fushate të suksesshme për rizgjedhje këtë muaj. Të premtën mijëra njerëz, kryesisht gra, protestu-



an në Varshavë dhe qytete të tjera kundër propozimeve për ta refuzuar traktatin.



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

# Lume's Details

## Estetik & Depilim



044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshohet banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- ▶ Lëshohet banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- ▶ Lëshohet banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044\558-894 Prishtinë.
- ▶ Lëshohet me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044\706-079.
- ▶ Lëshohet banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.
- ▶ Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045\699-221.
- ▶ Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.
- ▶ Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044\162-783
- ▶ Lëshohet banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.
- ▶ Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përball Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesën mund ta shiheni çdo ditë. Numri i telefonit: 049\402-518.
- ▶ Shesim banesën dy dhomshe në Ulpiana D8 h3 Nr 15 kati 3 ndërtim i vjetër, e rinovuar komplet, me nxemje të qytetit , çmimi 77 000€. Informatat tel:049\400-958 dhe 044\627-387
- ▶ Lëshohet banesën e pamobiluar (garsonierë) me qira. Banesa, e cila gjendet rrugës për në Gërmi, 150 metra afër Kolegjit Amerikan A.U.K, ndodhet në katin 5. Çmimi 130 euro. Tel: 049\705-503 dhe 049\662-211.
- ▶ Lëshohet banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshohet shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshohet banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshohet banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshohet banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshohet banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshohet garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshohet lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshohet banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshohet banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044\332-640.
- ▶ Lëshohet banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044\332-640.
- ▶ Lëshohet banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049\900-994.
- ▶ Lëshohet banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044\262-940 dhe 049/ 737-867.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

